

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7697 E premte 2 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nuk ka mënyrë më të mirë për të kuptuar frikën e shkaktuar nga "bomba" që përgatitet të plasë opozita, sesa të vëzhgosh se si reagon pala që mund ...

Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI

Në Kryeministri ka pllakosur paniku



Intervista

Ditës

Vizita e planifikuar e kryeministrit izraelit, Benjamin Netanjahu në Shqipëri është historike dhe mund të hapë dyert e bashkëpunimit mes dy vendeve në ...

Vijon në faqen 21

Nga AVITAL LEIBOVICH

Çfarë sjell vizita e Netanjahut në Shqipëri



Udhëtim, akomodim dhe pagesë mujore

Bursat për në SHBA, ambasada amerikane: Studentë, kushtet për të përfituar

Lotaria amerikane, DASH: Ka probleme, si mund t'i shmangni vështirësitë gjatë aplikimit

Ambasada amerikane ka publikuar dje udhëzimin për të gjithë studentët shqiptarë që janë të interesuar për të studiuar me bursë të plotë përtej Atlantikut. "Aplikimet për Programin Global UGRAD 2018-2019 janë hapur! Global UGRAD është një program shkëmbimi i pavarur, i konceptuar për t'i ekspozuar studentët ndaj ...

Në faqen 8-9

BISEDA E TRETË E KRYEBASHKIAKUT TE DURRESIT ME TE ARRESTUARIN "NIÇE"

PERGJIMET E REJA TE DAKOS ME GRUPIN E SHIJAKUT: IK PA MERAK

Kryetari i bashkisë i jep garanci Altin Avdylyt, që u prangos në kuadër të operacionit "Vol-Vo 4": 'Këto ditë do ta mbaroj unë atë'. Bisedat e para për blerjen e votave



(Në foto) Kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako. Faksimile e përgjimit



"FILDES HAFIZI"

Vrau gjyqtaren, burri në gjykatë: Pagova për shkollën dhe pushimet e saj

Në faqen 6

DEPUTETI I PS

Alket Hyseni: Sondazhet, Veliaj e merr mandatin e dytë me 63% të votave

Në faqen 10

MINISTRI I BRENDSEHM

Dekretimi i Lleshit, Meta kërkesë të Xhaçka për statusin e ish-ushtarakut

Në faqen 4

MARREVESHJA E RE

Turqia paralajmëron Greqinë për 12 mijlet detare: Po e shpallë, do të veprojë ushtria

Në faqen 17

"UNE JAM I PASTER"



Tahiri: Bilbila e kopila, bashkë kundër meje. PD-LSI: Krimin e bëre në Shqipëri, jo Itali

Në faqen 3

Konferenca/ Guvernatori Gent Sejko: Realiteti ekonomik, sfidues për politikën monetare

Rama vlerëson BSH: Pikë referimi për të gjithë

Ahmetaj: 4.3% rritje ekonomike në 2019, parashikohet më e larta në rajon

Kryeministri Edi Rama u shpreh se Banka e Shqipërisë është i vetmi institucion që nuk është anatemuar dhe përbën një mbështetje shumë solide dhe garanci të fortë në raport me qeverinë. Kryeministri theksoi se, "BSH është ndoshta i vetmi institucion që rrezaton një



qëndrueshmëri konstante në të gjithë periudhën e ekzistencës së vet, pas rënies së komunizmit". "Nëse nuk i kam bërë gabim llogaritë, BSH është i vetmi institucion në këtë vend që nuk është anatemuar nga njëra palë për llogari të kacafytjes ...

Në faqen 11

DORËHEQJA REAGIMET

Deputeti gjerman: Akuzat ndaj ministrit të Brendshëm po bëheshin të papranueshme

Valentina Madani

Gjermania përmes raportuesit të saj për Shqipërinë, Thorsten Frei, i kërkon Shqipërisë më shumë rezultate nga lufta kundër krimit të organizuar, tani që ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, është larguar. Në një intervistë për agjencinë ndërkombëtare të lajmeve "Deutsche Welle", ligjvënisi gjerman deklaroi se pretendimet ndaj ish-ministrit dhe veçitë tij për përfshirje në aktivitetet të jashtëligjshme ishin të papranueshme në Gjermani. "Është e vështirë të gjykosësh së largu se cilat kanë qenë shkaqet e dorëheqjes së tij. Sidoqoftë, unë e kam theksuar gjithnjë, se thasethemet dhe supozimet e lidhura me zotin Xhafajin edhe për ca kohë do të ishin të papranueshme politikisht në Gjermani. Mendoj se dorëheqja është një tregues tjetër në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përkatësisht shkëputjes nga politika", tha z.Frei. Deputeti i Bundestagut thekson se qeveria duhet të shtojë përpjekjet në luftën kundër krimit të organizuar. "Është e vërtetë që ndërkohë janë bërë përpjekje të mëdha me vettingun, por unë jam ende shumë i shqetësuar për gjendjen e krimit të organizuar. Kjo pikë do të luajë në fillim të verës së ardhshme një rol shumë vendimtar, kur në tryezë të kthehet sërish çështja e negociatave të anëtarësimit. Mbetet të presim se cili është roli që do të luajë pasardhësi i tij dhe se a do të jetë në gjendje ai të dëshmojë rezultate të shpejta. Jam optimist me rezerva se dorëheqja e Xhafajit, për vendin do të jetë një hap i vogël pozitiv përpara dhe drejt Europës", deklaroi Thorsten Frei. Ndërkohë, "Deutsche Welle" shkruan se pasardhësi i Xhafajit, Sandër Lleshi, përveç pastërtisë së emrit, ka përparësi edhe eksperiencën perëndimore dhe drejtimin e një përfaqësie diplomatike në Gjermani disa vite më parë.

Frei: Dorëheqja e Xhafajit, hap pozitiv kundër krimit të organizuar


"Pritshmëritë nga ministri i ri janë të mëdha"



Raportuesi i Gjermanisë për Shqipërinë, Thorsten Frei

DEKLARATA

"Është e vështirë të gjykosësh së largu se cilat kanë qenë shkaqet e dorëheqjes së tij. Supozimet e lidhura me zotin Xhafajin edhe për ca kohë do të ishin të papranueshme politikisht në Gjermani. Unë shpreh optimizëm me rezerva, se dorëheqja e Xhafajit është për vendin një hap i vogël pozitiv përpara dhe drejt Europës", tha z.Thorsten Frei.



Gjatë një seance parlamentare

Kuvendi, ministri në detyrë ulet në fund

Xhafaj, gazetarëve: Nuk është faji im që nuk keni kuptuar ato që kam thënë

Kuvendi u mblodh dje në seancë plenare, ku sërish mungoi Partia Demokratike dhe LSI-ja. Në seancë mori pjesë edhe Fatmir Xhafaj, i cili qëndroi i ulur për pak minuta në fundin e sallës dhe jo në karrigen e ministrit e më pas u largua. I pyetur nga gazetarët se cila ishte arsyeja e largimit të tij, Xhafaj tha se arsyeja ishte se ai ishte i shqetësuar nga komentet e tjerë. Ah, nuk është faji im që nuk i keni kuptuar ato që kam thënë", deklaroi z.Xhafaj. Ai do të qëndrojë në detyrë deri në momentin kur presidenti Ilir Meta do të dekretojë ministrin e ri, Sandër Lleshi. Në rendin e ditës në seancën e djeshme plenare ishte edhe votimi i dy anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rezarta Bitri dhe Bledar Skënderi. Dy anëtarët e KQZ janë zgjedhur me 74 vota. Gjithashtu, në rendin e ditës ishte edhe ratifikimi i marrëveshjes me Malin e Zi.



jtët, Aleanca 90, u fokusua te reformat e ndërmarrja nga Qeveria shqiptare, të cilat synojnë forcimin e shtetit ligjor në vend dhe njëkohësisht përmirësimin e standardeve të kërkuara nga procesi i integritimit evropian të vendit. Ministria Gjornaj i ka falënderuar de-

putetët gjermanë për mbështetjen që i kanë dhënë Shqipërisë në procesin e integritimit në familjen evropiane dhe i ka siguruar se qeveria është e fokusuar maksimalisht në plotësimin e të gjitha prioritetëve të kërkuara për çeljen e negociatave për anëtarësim në

BE. "Në këtë kontekst një vend të rëndësishëm zë reforma në drejtësi, zbatimi i së cilës është duke realizuar një ndryshim radikal dhe unik në llojin e vet në të gjithë rajonin, por edhe më gjerë", u shpreh Gjonaj. Sipas ministres Gjonaj, rezultatet e para të procesit të vettingut janë pritur me optimizëm nga shumica dërmuese e qytetarëve shqiptarë. Deputetët gjermanë shprehën interes lidhur me ecurinë e reformës, krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë dhe bllokimin e amendamenteve të pakëtës së reformës në parlament. Kreu i Komitetit për Çështjet Ligjore dhe të Konsumatorit, z. Stephan Brandner, theksoi se Qeveria shqiptare do të vazhdojë të ketë mbështetjen e plotë të Gjermanisë për të gjitha reformat e ndërmarrja, me qëllim që të shpejtohet rruga e integritimit në Bashkimin Evropian. Lidhur me çështjen e ngritjes nga delegacioni gjerman për mënyrën se si do të plotësohen vakancat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të krijuara nga vetingu, ministria Gjornaj është shprehur se mazhoranca ka bërë përpjekjet maksimale për miratimin e ndryshimeve ligjore për kuotat e reja për Shkollën e Magjistraturës, miratim i cili nuk u arrit për shkak të mosvotimit të tyre nga opozita. Tani pritet ngritja e dy këshillave, me qëllim që të përcaktohet numri i studentëve që do të ndjekë Shkollën e Magjistraturës për t'u përfshirë më pas në sistem si gjyqtarë ose prokurorë. Masat antikorrupsionit të qeverisë ishin një tjetër temë e rëndësishme, për të cilën deputetët gjermanë treguan interes të veçantë.

Shqipëria në BE, ish-kreu i Asamblesë së KE-së: Holanda nuk ju bllokoi dot

Integrimi i Shqipërisë në BE varet nga plotësimi i kushteve të konsideruara "detyra shtëpie" dhe vullneti i vendit për të ecur përpara. Ish-presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Rene Van Der Linden, nga Korça vlerësoi se vendi ka bërë progres në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe mbi të gjitha forcimin e shtetit ligjor. "Integrimi i Shqipërisë në BE varet nga dy faktorë. Së pari nga vetë ju, sepse nga përvoja e fundit e zgjerimit, nuk do të ketë më anëtarësime në grup, por secili vend do të kontrollohet veç. Jam i lumtur të ve re zhvillime dhe progres në Shqipëri. Ve re me kënaqësi që keni bërë progres në drejtim të shtetit ligjor dhe zhvillimit të ekonomisë. Por sot Europa është në një situatë të vështirë për shkak të Brexitit. Sot Europa përfaqëson ekonominë më të madhe, duhet të fuqizohen politikën e monitorimit të këtij zhvillimi, kështu që Italia nuk mund ta ndihmojë veten duke rritur borxhet. Por unë jam optimist për bashkëpunimin të vendeve të Europës edhe falë presidentit Trump dhe vullnetit politik të vendeve europiane", deklaroi z.Rene Van Der Linden. Holanda është një prej vendeve skeptike për integrimin e Shqipërisë në BE, por Van Der Linden, shprehet se në fund të këtij procesi, ajo nuk mund ta bllokojë anëtarësimin. Është e sigurt që në fund të këtij procesi, asnjë vend i BE nuk mund të bllokojë anëtarësimin e një shteti të ri. Jemi në fillim të procesit dhe sigurisht që kjo do të marrë më tepër kohë. Për Shqipërinë është e rëndësishme perspektiva e të qenit anëtarë e BE-së dhe duhet të ecë hap pas hapi në drejtim të integritimit. Shqipëria është vend që i përket Europës dhe anëtarë e NATO-s. Bashkimi Evropian ka kushte shumë më të forta se Këshilli i Europës dhe Shqipëria duhet të bëjë "detyrat e shtëpisë" ashtu siç duhet dhe këtë e them si një mik i Shqipërisë", tha z. Rene Van Der Linden. Politikani i njohur holandez u ndërua "Qytetar Nderi" në Korçë, ndërsa më herët qëndroi në Elbasan.





Ish-ministri i Brendshëm kërkoi nga Prokuroria që të konkludojë hetimet

Tahiri: Jam i pastër, gjyqin ma bëri politika dhe ambasadorët

"Unë them 'boll', nëse s'dalin 7 prokurorë, bëjini 70"

Një ditë pasi festoi ditëlindjen, ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, ka dalë para mediae për të kërkuar drejtësi edhe nga institucionet shqiptare, pasi gjykata italiane e ka zhveshur nga akuzat për bashkëpunim me bandën "Habilaj". Që në nisje të deklaratës së tij të gjatë, ai ka deklaruar se kishte gabuar me heshtjen e tij të gjatë në pritje të rezultateve të hetimeve, ndërsa nuk ka ngurruar që me tone kërcënuese të sulmojë prokurorët që e hetuan deri më tani, si dhe të gjithë politikën, median dhe opinionin publik që sipas tij i ka bërë gjyqin pa të drejtë. "Kam heshtur në respekt të hetimeve, edhe pse i vetmi që ka heshtur jam unë. Nëse do kisha zgjedhur të bëja politikamin, nuk do i kisha lënë rrrënjë e as dhëmballë të gjithë atyre që kanë folur? Pa kursyer as ata që kanë hetuar", tha Tahiri. Ish-ministri i Brendshëm evidentoi se ishte pikërisht ai vetë që u kërkoi organeve të drejtësisë italiane që të hotohej edhe nga ata, për të shpërndarë çdo hije dyshimi që mund të ngjalle një hetim vetëm në Shqipëri. Duke paraqitur para medias pikërisht vendimin për pushimin e hetimit të tij nga drejtësia italiane, Tahiri theksoi se tashmë ai ishte i pastër.



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

PËR OPOZITËN
"Nuk e kam të largët natën kur Saliu e Luli i shkuan për darkë në shtëpi në atë kohë të pandehurit Ilir Meta, vetëm një ditë para vendimit të gjykatës. E pasi kishin larë duart me drejtësinë, tallnin 'kurabien' me popullin duke i treguar sa mirë kishte gatuar Monika roston me kumbulla", theksoi Tahiri.

PËR AMBASADORËT

"Me vrap edhe ambasadorë, pa u menduar dy herë e pa pasur gajle se në vendet e tyre as do ia vinte njeriu në pullë në qoftë se do të flisnin kaq sa flasin këtu, e as do guxonin të flisnin për një proces ku heton prokuroria, e prapë kanë folur. Tamam si për ta bërë të vërtetë atë shprehjen 'Shqipëri hesapi', tha z.Tahiri.



Vasili, Tahirit: Moral moçali, sorra u përpoq të zbardhej

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, reagoi dje ashpër ndaj ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, ku ky i fundit në një konferencë për shtyp njoftoi se prokuroria e Katanis kishte mbyllur hetimet ndaj tij. Vasili akuzoi Tahirin si shkakhtar të mbledhjes së hashashit në vend. Mes ironisë, Vasili tha se "moral moçali foli. Sorra u përpoq të zbardhej duke u bërë sterrë e zezë edhe më shumë". "Kryer-ruspia e drogës që do të fshihet si struci me menderen përjashta. Rruspia u foli rilindasve në emër të përgjimeve erotike dhe të drogës të horrave me të cilët bashkëqeverisi, nga ai më i gjatë në krye e deri tek më të gjatat e më të shkurtrat rreth e përqark. Ai që qelbi Shqipërinë me droge, ai që qelbi policinë me krim, ai që helmoi shkollat tej e tej me hashash e kokainë, pacipësisht bën sot moral. Moral moçali foli. Sorra e përpoq të zbardhej, duke u bërë sterrë e zezë edhe më shumë. Shtitje e aksioneve të policisë të trafikantët dhe tradhtimi i punës së shërbimeve mike, makina, jahte, miliona euro nëpër makina dhe shtetin në dispozicion të maskarenjve të drogës, këto bëma të sorrës së zezë i di Shqipëria anë e mbanë dhe s'ka gjetehe fiku që ia fshod dot sikur ta vënë as para, as prapa. Këtyrë hesapi të palarë me shqiptarët nuk i shpëton dot sikur të bëjë edhe si rruspia, edhe si çingjije", shprehet z. Vasili.

PD: Hetimi italian për Tahirin, i pavlerë

Dokumenti i Tahirit, PD: S'ka lidhje, krimin e kreu në Shqipëri

Demokratët reagoan dje pas daljes së Saimir Tahirit para mediae, duke e cilësuar të pavlerë dokumentin e publikuar prej tij. Gazment Bardhi e quajti shfaqjen si një goditje të rëndë të reformës në drejtësi dhe u bëri thirrje ndërkom-bëtareve të mos lejojnë që Saimir Tahiri të shpëtojë pa u ndëshkuar. Dokumenti që ai valëvit për pafajësinë e tij është i pavlerë për veprimtarinë e tij kriminale në Shqipëri. Hetimi italian është i parëndësishëm dhe nuk ka lidhje fare me hetimin në Shqipëri. Saimir Tahiri nuk i ka kryer krimet në Itali, por në Shqipëri. Si ministër i Brendshëm, akuzohet për lehtësimin dhe mbështetjen shtetërore për trafikun e drogës nga organizata kriminale e Habilajve në Shqipëri", u shpreh këshilltari ligjor i PD, Gazment Bardhi. Ndaj, edhe daljen e ish-ministrit të Brendshëm përpara medias, demokratët e cilësojnë skenar të orkestruar nga kryeministri Rama, për të shpëtuar nga drejtësia ish-vartësin e



AKUZA

"Saimir Tahiri kërcënoi si mafioz çdo prokuror dhe gjyqtar që mund të guxojë të mos u bindet urdhrave dhe të vazhdojnë hetimin ndaj tij. Pas këtyre kërcënimeve, prokuroria duhet të kërkojë ndryshimin e masës së sigurisë nga 'detyrim paraqitje', në 'arrest me burg' për Tahirin", tha Bardhi.

tij. "Qëllimi kryesor politik i Edi Ramës prej një viti është që Saimir Tahiri t'i shpëtojë drejtësisë dhe të mos ndëshkohet. Zgjidhja që Rama dhe Tahiri kanë gjetur është që prokuroria të prishë hetimet dhe të rrezojë çdo akuzë për mbështetjen nga Tahiri të organizatës kriminale të Habilajve dhe trafikun të drogës", tha Bardhi. Pas fjalimit të ish-ministrit të Brendshëm, opozita sheh kërcënimin e hapur që ajo thotë se Tahiri i bërë sistemit të drejtësisë, ndaj dhe adresoi një thirrje në adresë të organ-

it të akuzës. "Saimir Tahiri kërcënoi si mafioz çdo prokuror dhe gjyqtar që mund të guxojë të mos u bindet urdhrave dhe të vazhdojnë hetimin ndaj tij. Pas këtyre kërcënimeve, prokuroria duhet të kërkojë ndryshimin e masës së sigurisë nga 'detyrim paraqitje', në 'arrest me burg' për Saimir Tahirin", tha këshilltari ligjor i PD. Për demokratët, gjuha e dor-dur nga Tahiri përbën ve-pr penale dhe se shfaqja e tij është një goditje e rëndë ndaj reformës në drejtësi.

akuzova e nuk bëra politikë, nuk u fshahe, nuk gënjeva, nuk sajova. Unë u përballa. Dhe sot jam i vetmi politikan shqiptar që vetëm pse përmend në bisedat e ca trafikantëve, kërkova vetë e jam hetuar jo një herë, por dy herë nga Prokuroria e Antimafias italiane", theksoi ai. Ndaj, tashmë që drejtësia italiane foli, Tahiri kërkoi që edhe prokuroria shqiptare të

konkludojë për hetimet që ka nisur prej më shumë se një viti. "Janë 7 prokurorë në çështjen time. Ka kaluar 1 vit. Dokumentin e Italisë e dorëzova të hënën në prokurori. Unë them 'boll', nuk kam më çfarë të pres. Nëse s'dalin 7 prokurorë, bëjini 70. Deri tani është hetuar gjithçka për mua. U bë një vit që prokuroria asnjë, por unë s'jam thirrur asnjë ditë të vetme", dek-

laroi Tahiri. Në deklaratën e tij Tahiri u mor gjatë edhe me rolin që luajtën në këtë proces politik të ambasadorë, duke evidentuar Lulzim Bashën, Ilir Metën dhe Sali Berishën. Në fund, ai deklaroi se e gjithë kjo histori dhe kjo kohë i dha mundësi të njohë më mirë njerëzit, kush i qëndroi pranë dhe kush punoi kundër tij, duke paralajmëruar kështu se ai nuk harron.

DEKRETI NGERCI

Neni 103 i Kushtetutës mban 'peng' dekretimin, Kuvendi shtyn votimin për pasuesin e Xhafajt

Valentina Madani

General Sandër Lleshi u propozua nga kryeministri Edi Rama për postin e Ministrit të Brendshëm ditën e shtunë, por presidenti Ilir Meta ende nuk ka firmosur dekretin. Në këtë mënyrë Fatmir Xhafaj do të vazhdojë të mbetet ministër i Brendshëm, të paktën edhe për disa ditë. Kjo pasi presidenti nuk i dha mundësi Kuvendit që të votonte dje për zëvendësimin e tij me gjeneral Sandër Lleshin, i propozuar nga kryeministri Edi Rama për të qenë ministri i ri i Brendshëm. Pavarësisht pritshmërive të shumicës qeverisëse se kreu i shtetit do ta bënte dje shpalljen e dekretit, kjo gjë nuk ka ndodhur. Ndaj Kuvendi shtyu votimin në një moment të dytë, sapo presidenti ta ushtrojë të drejtën e tij kushtetuese. Kryetari i Partisë Demokratike, bëri të ditur dje se stafi i presidentit foli dje për probleme kushtetuese që e pengojnë dekretimin e z. Lleshi.

"Unë di që stafi juridik i presidentit ka gjetur probleme kushtetuese që e pengojnë dekretimin e tij, po shihen me frymë përgjegjshmërie. Presidenti në parim ka qenë dakord, por dokumentet që ka në dispozicion... Ka një problem që shpresojmë mos të jetë serioz. Nuk e di çfarë problemi, por edhe ta dija nuk do ta thosha. Ministri i Brendshëm është figurë politike dhe duhet të jetë e tillë. Vendosi një ushtararak për 'urdhëro si urdhëron'. Nuk është profil politik. Ministri duhet të hartojë ligje dhe drejtëj politikë. Unë e njoh, nuk kam asnjë vërejtje për formimin, mund të ishte ministër i Mbrojtjes apo Drejtësisë, por jo i Brendshëm, pasi do të dështojë. Ai është ingjyrosur me ngjyrën e rilindjes. Dëshimi i këtij ministri do të jetë spektakolar", tha Nard Noka.

ARSYEJA

Që prej të dielës mbi tavolinën e Presidentit të Republikës Ilir Meta ndodhet kërkesa e kryeministrit Edi Rama për dekretimin e gjeneral Sandër Lleshit si ministër i Punëve të Brendshme. Megjithatë kanë kaluar disa ditë nga kjo kërkesë e kryeministrit Rama, ky dekret ende nuk ka marrë firmën e kreu të shtetit. Vonesa e Presidentit Meta për dekretimin e Sandër Lleshit duket se ka një shkak. Burime nga presidenca konfirmojnë për 'GSH' se shkak për këtë vonesë është bërë pikërisht detyrimi që lind nga zbatimi i nenit 98 i Kushtetutës, i cili përcakton se "ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drej-

Meta, Xhaçkës: Cili është statusi real dhe ligjor i Lleshit?

Ndoka: Presidenti zbuloi probleme që pengojnë dekretimin



Presidenti Ilir Meta

KËRKESA

Departamenti juridik i Presidencës i ka dërguar një kërkesë zyrtare Ministrisë së Mbrojtjes për të kuptuar se cili është statusi i Sandër Lleshit në Forcat e Armatosura. Deri në momentin e mbërritjes së përgjigjes Presidencës duket se nuk do të bëjë asnjë veprim për dekretimin e Sandër Lleshit.

**Berisha: Duarakullori i PS.
Dako: O plak, s'ka toç që të kthen**

Ish-kryeministri Sali Berisha postoi dje një video në rrjetin e tij social 'Facebook', ku sipas tij duket Sukthi i mbuluar nga tymi dhe blloza. Videoja është sjellë nga qytetari dixhital, i cili shkruan se pamjet nuk janë mjegull, por tym mbeturinash që digjen. "Nuk është një vrasje ngadalte për të gjithë banorët e Sukthi i Ri", shprehet z. Berisha. Por në reagimin e tij kreu i Bashkisë së Durrësit Vangush Dako shkruan se videoja e publikuar nga z. Berisha nuk është Durrësi pasi, sipas tij, qyteti ndodhet nga ana e majtë. "U bë e disata herë që ky plak nxjerr video nga bota e tretë që ia faturon Durrësit, po unë i them s'ka video dhe toç apo larvë që e kthen me pushtetin tënd o i vdekur dixhital!", shprehet në 'Facebook' z. Dako. Pas deklarativave të Dakos, ku shprehej 1 javë më parë se ishte Supermen dhe se "duart i kishte të pastra akullorë" përsa i përket lidhjeve me krimin, ish kryeministri publikoi një fotomontim. Në foton e publikuar duket një burrë i shkurtër, pas këmbës së të cilit fshihet stema e superheroit të animuar të fëmijëve "Supermen". "Duar akullori i narkopartisë siciliste", shprehet Berisha.

tues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse". Nisur pikërisht nga fakti se ministri i ri i propozuar mban gradën madhore "gjeneral" në forcat ushtarake, mësohet se Presidenti i Republikës i ka kërkuar informacion Ministrisë së Mbrojtjes cili është statusi real dhe ligjor i Lleshit në radhët e ushtrisë. Kjo pasi, siç bëhet e ditur, kryen i Kushtetutës nuk lejon që ministri i Brendshëm të

jetë njëkohësisht edhe një ushtarak me gradë madhore në ushtri.

AFATI

Gjithsesi pritja e Presidentit të Republikës nuk mund të zgjasë edhe për shumë ditë, pasi Kushtetuta i ka vendosur atij një afat të caktuar për të dekretuar ministrin e ri. Pikërisht Neni 98 i Kushtetutës përcakton se "ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës,

KUSHTETUTA

- **NENI 98**
 1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve.
 2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi
- **NENI 103**
 1. Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet.
 2. Ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse.
 3. Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit

Kryemadhi në Pekin: Shqipëria, potencial në fushën e turizmit

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi nga Universtiteti i Unionit të Pekinit foli për potencialin e Shqipërisë në fushën e turizmit dhe nevojën për aftësim profesional në këtë sektor. "Sektori i turizmit është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, ndërkohë që ende kemi një mungesë të madhe në edukimin e profesionistëve në këtë fushë", tha znj. Kryemadhi. Kryemadhi i bëri ftesë Universitetit të Unionit të Pekinit që të vizitonte Shqipërinë, duke vendosur theksin te fillimi i marrëdhënies së bashkëpunimit me universitetet shqiptare. "Instituti Konfuci është, gjithashtu, një platformë e shkëlqyer nëpërmjet të cilit mund të nxisim bashkëpunimin", u shpreh kryetarja e LSI-së. Kryemadhi vlerësoi, gjithashtu, punën e jashtëzakonshme që është bërë nga ambasada e Kinës në Tiranë, për promovimin e marrëdhënies ndërmjet dy vendeve.



me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve". Duke patur parasysh se propozimi i Ramës në presidencë ka mbërritur të shtunën më datë 27 tetor, atëherë sipas këtij përcaktimi kushtetues, Presidenti Meta ka afat edhe dy ditë për të dekretuar emrin e Lleshit si ministër i Brendshëm. Vetë Kushtetuta nuk i lë shumë hapësirë Presidentit të Republikës në rastin e dekretimit të një ministri.

Ndërsye nga rasti i dekretive të ligjeve, në rastin e ministrit Kushtetuta nuk parashikon mundësinë e kthimit të emërimit të propozuar nga kryeministri. Ndaj nisur pikërisht nga ky përcaktim, pritet që kreu i shtetit të dekretojë emërimin e Sandër Lleshit brenda dy ditëve të ardhshme. Gjithsesi marrja e detyrës prej tij mbetet vetëm për javën tjetër, kjo pasi duhet të mblidhet Kuvendi për ta



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë një mbledhjeje



Ish-kryeministri: Aeroporti i Kukësit, Rama prezanton kopjen e një projekti në Gjeorgji
Pak ditë pasi shkarkoi z. kryeministrit e Arsimit për plagjiaturë, kryeministri Rama u ka shfaqur kukësiëve projektin e aeroportit të Kukësit që është një kopje e një projekti në Gjeorgji. Kopjimi i projektit gjeorgjian nga qeveria u denoncua edhe nga ish-kryeministri Berisha, i cili tha se Rama ka mashtruar me projektin për aeroportin e Kukësit. "Si tha, "Mos përgojoni 3D-në"??? Ky e ha turpin me bukë. Ja që rezultoi se ajo 3D-ja, projekti aeroportit të Kukësit që paraqiti dje është projekt i një aeroporti në Gjeorgji. 3D-të janë identike. Mirë që është kujdesur të heqë ujën dhe shinat e trenit", - u shpreh z. Berisha.

votuar. Burime nga PS bënë të ditur se nuk përjashtohet mundësia edhe e thirrjes së Kuvendit në një seancë jashtë radhe, për shkak se nuk mund të lihet vendi pa ministër të libhet vendi për një kohë të gjatë. Deri atëherë në bazë të ligjit themelart ministër i Brendshëm do të mbetet Fatmir Xhafaj, pavarësisht se largimi i tij nga qeveria është dekretuar prej të shtunës nga Meta.



Parlamenti ka votuar me votat e socialistëve dy kandidaturat për anëtarë KQZ-je

PS merr shumicën në KQZ, opozita mbetet me një anëtar

Balla, Bashës: Mund të propozosh dy emra

Mazhoranca e majtë ka mundur të marrë shumicën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kuvendi ka votuar dje vetëm me votat e deputetëve të majtë dy propozimet e ardhura prej Partisë Socialiste për dy vende vakante në institucionin qendror të administrimit të zgjedhjeve në vend. Bëhet fjalë për Bledar Skënderin dhe Rezarta Bitrin, të cilët tashmë kanë zënë vendet e dy anëtarëve të propozuar më parë nga PD në KQZ, respektivisht, Hysen Osmanaj dhe Vera Shtjefnit. Të dy kandidatët e votuar dje kanë marrë nga 74 vota, ndërka me këtë veprim socialistët sigurojnë shumicën në KQZ, çka u krijon atyre mundësinë jo vetëm që të zhblllojnë ngërçin e krijuar për shkak të kuorumit, por edhe të kenë mundësi që të diktojnë me votën e tyre vendimarrjen e tij. Kjo, pasi tashmë të majtë kanë në këtë institucion plotë 4 anëtarë, Denar Bibën, Edlira Jorgaqin, Bledar Skënderin dhe Rezarta Bitrin. Ndërkohë që opozita në mënyrë faktike aktualisht ka vetëm një anëtar, Klement Zgurin, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i KQZ-së. Ndërkohë që mbeten vakante dy vendet që mazhoranca ia ka lënë opozitës. Bëhet fjalë për vendin e mbetur vakant nga mbarimi i mandatit të Bledar Skënderit dhe atij të përfaqësuesit të LSI-së, Gëzim Velshnjës, të cilëve gjithashtu u ka mbaruar mandati dhe që prej disa javësh nuk mund të paraqiten më në mbledhjet e KQZ-së.

opozitës një vend në KQZ. "Aprovimi i dy kandidaturave nga PS-ja përbën një shkelje të ligjit. PS-ja nuk ka të drejtë në kuadrin aktual ligjor që të propozojë dy kandidatura, por ka uzurpuar një kandidaturë të opozitës, që është një shenjë e degradimit total të pushtetit. Është kapje e paligjshme e KQZ-së dhe natyrisht që opozita nuk mund dhe nuk do të bëhet pjesë e kësaj. Vetë KQZ-ja në rëndësinë që ka në procesin zgjedhor është një pjesë e problematikës që ka prodhuar ky pushtet", u shpreh Basha.

Por, këtij pretendimi i është përgjigjur dje nga foltorja e Kuvendit kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili deklaroi se në total nga 4 vendet e mbetura vakante, opozitës i takonin dy, por jo ata që morën dy kandidatët e votuar nga parlamenti. "Lulzim, të takojnë dy kandidatura, jo një! Pra, nga katër vakanca të krijuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dy kandidatura i takojnë mazhorancës dhe dy i takojnë opozitës, jo një. Nuk ta kanë shpjeguar mirë Lulzim të tutë; nga katër, ke gjysmat. Për sa i përket partisë që ka numrin më të madh të mandateve, në shumicë jemi vetëm ne, Partia Socialiste e Shqipërisë", tha Balla.

Por, këtij pretendimi i është përgjigjur dje nga foltorja e Kuvendit kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili deklaroi se në total nga 4 vendet e mbetura vakante, opozitës i takonin dy, por jo ata që morën dy kandidatët e votuar nga parlamenti. "Lulzim, të takojnë dy kandidatura, jo një! Pra, nga katër vakanca të krijuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dy kandidatura i takojnë mazhorancës dhe dy i takojnë opozitës, jo një. Nuk ta kanë shpjeguar mirë Lulzim të tutë; nga katër, ke gjysmat. Për sa i përket partisë që ka numrin më të madh të mandateve, në shumicë jemi vetëm ne, Partia Socialiste e Shqipërisë. Kjo do të thotë se të dyja vendet që i takonin shumicës parlamentare të legjislaturës së vitit 2009-2013, tashmë i takojnë shumicës parlamentare të legjislaturës 2017-2021. Dy ish-anëtarët e KQZ-së, Vera Shtjefni dhe anëtarit tjetër janë dy anëtarë që kanë qënë propozime të Partisë Demokratike, automatikisht dy propozimet e reja i takojnë Partisë Socialiste", shtoi Balla. Ndaj, ai i bëri thirrje Partisë Demokratike të sjellë dy kandidaturat e saj për anëtarë të KQZ-së.



Kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla

TAULANT BALLA

"Lulzim, të takojnë dy kandidatura, jo një! Pra, nga katër vakanca të krijuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dy kandidatura i takojnë mazhorancës dhe dy i takojnë opozitës, jo një. Nuk ta kanë shpjeguar mirë Lulzim të tutë; nga katër, ke gjysmat. Për sa i përket partisë që ka numrin më të madh të mandateve në shumicë jemi vetëm ne, Partia Socialiste e Shqipërisë", tha Balla.

Meta, në Firence për 90-vjetorin e Kardinal Troshanit: Edhe 100 vite të tjera!

Presidenti Ilir Meta zhvilloi dje një vizitë në Firence, ku veç takimit me kryebashkiakun Nario Nardella, morri pjesë edhe në festimet e organizuara me rastin e 90-vjetorit të kardinalit shqiptar, Ernest Troshani. Ishte vetë Meta, ai që bëri të ditur dje se qëllimi i kësaj vizite ishte ditëlindja e kardinalit Troshani. "Sot në Firence me kryetarin e bashkisë, Dario Nardella, për meshën e gjithë shenjtorëve, për nder të 90-vjetorit të lindjes së kardinalit tonë Ernest Troshani", shkruan Meta duke postuar edhe një foto me kryetarin e Bashkisë së Firences. Më pas ai publikoi edhe disa foto me vetë kardinalin, ndërsa i ka uruar atij jetë të gjatë. "Edhe 100 vite të tjera kardinalit tonë Troshani, duke falënderuar për mikpritjen kardinalin e Firences, Betori; kryebashkiakun Nardella dhe autoritetet vendore në Firence, me të cilët festuam sot ditëlindjen e kardinal Troshanit në Ipeshkvinë e Firences", shkroi Meta.

PS, Ndreu: Lë politikën, nëse më gjeni në fis një trafikant

Dy ditë më parë ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi deputetin socialist, Pjerin Ndreu, se kishte lidhje me fisin Ndokaj në Lezhë dhe se së bashku me ta ka siguruar përfitime të paligjshme. Dje nga salla e parlamentit, deputeti i PS-së për zonën e Lezhës, Pjerin Ndreu ka sfiduar Berishën lidhur me këto akuza. Ai deklaroi se ishte i gatshëm të hiqte dorë nga politika nëse Berisha arrin t'i gjejë qoftë edhe një të implikuar në fisin e tij me krimin apo aferat e paligjshme. "E lë politikën nëse ish-kryeministri Berisha, të cilin nuk nguroj ta quaj sërish një plak matuf, gjen qoftë edhe një të implikuar në fisin e tij deri në 5 breza. Ai dihet kush është, shqiptarët e dinë publikisht, ndaj i them Saliut se deri në 5 breza nuk kam një kontingjent për trafikë. E sfidoj të dalë publikisht dhe që t'i gjejë", tha Ndreu.

KODI ZGJEDHOR

- **NENI 14**
Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së
- 1. Kuvendi i Shqipërisë zgjedh anëtarët e KQZ-së sipas kësaj procedure:
 - a) 2 anëtarë propozohen nga partitë e shumicës parlamentare dhe 2 anëtarë nga partia e opozitës parlamentare që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvendin e Shqipërisë.
 - b) Subjektet propozuese, në fazën e përzgjedhjes paraqesin jo më pak se dy kandidatura për secilën vakancë. Kryetarët e grupeve parlamentare të subjekteve propozuese përzgjedhin kolegjialisht 4 kandidatura, në përputhje me kriteret e parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike. Subjektet propozuese të shkronjës "a" përzgjedhin një kandidaturë nga secila gjini.
 - c) Kandidaturat e përzgjedhura sipas shkronjës "b" të kësaj pike i paraqiten Kuvendit për miratim.
 - ç) Anëtarit i pestë i KQZ-së zgjidhet nga kandidatura të propozuara nga grupime deputetësh të partive të shumicës parlamentare, përjashtuar partinë më të madhe të grupimit të shumicës. Anëtarit i gjashtë i KQZ-së zgjidhet nga kandidatura të propozuara nga grupime deputetësh të partive të opozitës parlamentare, përjashtuar partinë më të madhe të opozitës. Grupimi propozues paraqet një listë me jo më pak se dy kandidatura për vakancën përkatëse.

Negotiatat, Xhaçka: Lajmi i mirë do vijë nga Rumania

Me ftesë të homologut të saj rumun, ministria e Mbrojtjes, Oltia Xhaçka zhvilloi një vizitë zyrtare në Ruman, ku u prit në një takim të veçantë nga kryeministria Viorica D'ncil?, ministri i Mbrojtjes Mihai Fifor, përfaqësues të Komisionit të Sigurisë dhe të Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë, ndërsa ka marrë pjesë në seancën plenare të Parlamentit të Rumanisë. Në takimet e zhvilluara me kryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes rumun, ministria Xhaçka ka marrë përgjigje për ecurinë e reformave dhe për rolin konstruktiv që Shqipëria luan në rajon. "105 vjet më parë Rumania ka qënë vendi i parë që ka njohur Pavarësinë e Shqipërisë dhe po në Ruman është marrë edhe ftesa që Shqipëria të bëhet anëtarë me të drejta të plota e NATO-s. Jam e sigurt që do të kemi një lajm të mirë po nga Rumania vitin e ardhshëm, kur Rumania të marrë Presidencën e radhës së BE", tha Xhaçka.

Burri vrasës rrëfhet në Gjykatën e Krimeve të Rënda: Ja si e njoha Fildes Hafizin

Ekzekutimi i gjyqtares, Fadil Kasemi: Kam paguar për shkollimin, qiranë e pushimet

TIRANË

Në Gjykatën e Krimeve të Rënda në Tiranë, dje u zhvillua seanca gjyqësore ndaj Fadil Kasemit, i cili më 31 gusht të vitit që shkoi vrau gruan e tij, gjyqtaren Fildes Hafizin. Në seancën, e cila fillimisht u zhvillua me dyer të hapura dhe ku ishin të pranishëm familjarë të viktimës dhe të autorit, ky i fundit ka treguar përballë trupit gjykues se si është njohur me ish-bashkëshorten e tij. Prezent në sallën e gjyqit ishin edhe dy ekspertë mjeko-ligjorë, që pasi të degjojnë dëshminë, do të përcaktojnë nëse Kasemi ka probleme të shëndetit mendor ose jo. Ka qenë avokati mbrojtës që pretendon se klienti i tij ka shfaqur probleme dhe për këtë ka kërkuar që gjendja e tij mendore të vlerësohet nga ekspertët. Përballë togave të zeza, 53-vjeçari ka treguar se është njohur me të ndërjet në fund të vitit 2000, në kohën kur ishte kthyer nga emigrimi. Kasemi ka rrëfyer se ka investuar për shkollimin dhe punësimin e ish-bashkëshortes, ndërsa për 15 vite ka paguar edhe qiranë e banesës së prindërve të saj. Ndërsa problemet e para në çift kanë nisur në 13 shkurt të 2015. "Për shkollën e



Fadil Kasemi në sallën e gjyqit

VRASJA

Ngjarja e rëndë ku mbeti e vrarë Fildes Hafizi ndodhi në Tiranë, më 31 gusht të vitit 2017, në zonën e "Xhamllikut" në Tiranë. Gjyqtarja sapo kishte dalë nga parukiaria dhe po hipte në makinë, kur ish-bashkëshorti, Fadil Kasemi i është afruar dhe e ka qëlluar atë me një plumb në kokë. Pas vrasjes së nënës së dy fëmijëve, Kasemi u vu në pranga, ndërsa pranoi autorësinë e krimit.

magjistraturës e kam financuar unë, edhe pse e kam bërë në një mënyrë jo të ndershme dhe jo ligjore. Deri para magjistraturës marrëdhëniet tona kanë qenë shumë të mira. Më pas filloi të më thoshte shprehje që nuk i

kuptoja. Më mbyllte telefonin, më thoshte s'i do fëmijët, më thoshte që kaq të urtë jeni si vëllezër të gjithë, ke ndonjë armë të fshehur diku. Bënim nga një muaj pushime dhe së bashku me prindërit e saj, që i kisha

me vete. U kam paguar qiranë për 15 vite dhe asnjëherë s'jam interesuar sa e ka pasur gruaja ime rrogën", është shprehur i akuzuari. Gjithashtu, 53-vjeçari tregoi se kishte futur bashkëshorten e tij të festonin Shën Valentinin, por Hafizi e kishte refuzuar me argumentin se do të festonte me një shoqen e saj. Pas kësaj, gjykata ka vendosur të zhvillojë seancën me dyer të mbyllura, pasi i pandehuri ka kërkuar të tregojë 4 momente të jetës së tyre në çift, të cilat Kasemi i ka cilësuar si intime.



Shpërndanin heroinë dhe kanabis në qytet, bien në pranga tre persona

LUSHNJË - Tre persona janë arrestuar nga policia e Lushnjës, pasi dyshohen se janë pjesë e një grupi kriminal, që furnizonte qytetin me droga të forta. Burime zyrtare nga policia bënë dje me dije se në kuadër të operacionit të koduar "Louise" u prangosën shtetasit: Ervis Çoku, 34 vjeç; Erjon Çoku, 39 vjeç si dhe Ervin Kiptiu, 38 vjeç, të tre banues në Lushnjë. Mësohet se gjatë këtij operacioni u sekuestruar heroinë, kanabis sativa dhe një armë zjarri. Operacioni në fjalë erdhi pas një hetimi 3-mujor të ndjekur me metodat proaktive nga efektivët e Komisarariatit të Lushnjës. Ndërkaq, gjatë kontrollëve të ushtruara në ambientet e frekuentuara nga personat e mësipërm janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 30 doza me lëndë narkotike e dyshuar heroinë, një sasi lëndë narkotike e dyshuar kanabis sativa, një armë zjarri e tipit pistoletë "Zastava" si dhe një krehër me 8 copë fishekë. Për të tre shtetasit e arrestuar, Gjykata e Shkallës së Parë Lushnjë ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Prodhimin dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim. Ndërkaq, policia po vijon veprimet e mëtejshme hetimore, me qëllim dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale, si identifikimin e kapjen e personave të tjerë të përfshirë në shpërndarjen e drogave të forta.

PERSONAT E ARRESTUAR	
1.	Ervis Çoku, 34 vjeç
2.	Erjon Çoku, 39 vjeç
3.	Ervin Kiptiu, 38 vjeç

NGJARJA

Granatë makinës së punonjësit të Tatimeve, në kërkim autorët

SHKODËR - Një ngjarje e rëndë është regjistruar dje në Shkodër, ku automjeti të një punonjësi të Tatimeve i është vendosur granatë. Ngjarja ka ndodhur në vendin e quajtur "Ura Dervishbeg". Ndërkohë, mësohet se objekti i sulmit është bërë mjeti i Nehat Zaganjorit. Fatmirësisht granata e vendosur në mjetin tip "Benz" nuk ka shpërthyer. Menjëherë në vendin e ngjarjes kanë shkuar forcat e policisë dhe kanë nisur hetimet. Grupi hetimor nga të dhënat e para ka dyshime se sinjalist kërcënues ndaj punonjësit të Tatimeve është për shkak të detyrës. Ndërkohë, vijojnë hetimet për zbardhjen e ngjarjes si dhe identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

"Në 2 vite, 4 të vdekur e shumë të plagosur në aksidente"

Banorët në Unazën perëndimore hidhen në protestë: Të vendosen kufizuesit e shpejtësisë e sinjalistika

SHKODËR - Banorë në Unazën perëndimore (tek ish-Poçeria) në Shkodër dje janë hedhur në protestë për shkak të rrezikshmërisë nga aksidentet automobilistike, ku në më pak se dy vite kanë humbur jetën 4 persona e shumë të tjerë janë plagosur. Ata kërkojnë nga pushteti vendor apo edhe institucionet e tjera që të merren masa për vendosjen e kufizuesve të shpejtësisë dhe vijave të bardha bashkë me sinjalistikën përkatëse. Makinat ecin me një shpejtësi mbi 100 km në orë në Unazë, duke bërë që banorët të jenë të rrezikuar, për shkak se banezat e tyre janë në anë të rrugës në një rrugicë dytësore që lidhet direkt me Unazën perëndimore. "Është një kryqëzim mjaft problematik për ne. Kalojnë fëmijët 3-4 herë në ditë. Këtu ka pasur disa aksi-



Protesta e banorëve në Shkodër

dente dhe në më pak se 2 vite kanë humbur jetën katër persona dhe shumë të tjerë janë plagosur si shkak i aksidentëve. Nëse situata nuk ndryshon, do ketë sërish aksidente. Kalojnë kamionët me 100 tonë dhe shpejtësi shumë të madhe. Edhe makinat e tjera dhe shoferët nuk e vendosin fare këmbën në fren. Ne kërkojmë që në të dyja anët e rrugës të vendosen dy kufizues shpejtësie. Nëse kufizohet shpejtësia, atëherë fëmijët mund të kenë më shumë siguri. Është pikë kalimi

shumë e keqe", u shpreh Luigj Malaj, një prej protestuesve. Qazim Drangu është prej atyre që ka pësuar aksident, por fatmirësisht ka shpëtuar. "Nuk po thotë kush për semaforë se nuk ka e gjithë Shkodra, as sinjalistikë nuk ka, por të paktën dy kufizues shpejtësie dhe dy vija të bardha duhet të jenë. Nëse rrezikshmëria për aksidente është 80%, të paktën ta ulin në 50 a 60%. Jemi të rrezikuar sa s'ka ku të shkojë më. Mua para pak kohësh më kanë aksidentuar këtu, sepse erdhi

një makinë me shumë shpejtësi nga mbrapa dhe më ra me pasqyra dhe iku. Më kapën të tjerët që ishin në lokal", tha Drangu. Për fëmijët tek ish-Poçeria, por edhe nxënësit e tjerë, duke qenë se në afërsi është shkolla 9-vjeçare "Azem Hajdari", e vetmja mundësi është shpëtimi nga prindërit deklaroi protestuesi Tahir Vucaj. Ndërkaq, Sytki Alivoda dhe shokët, me të cilët ai kalon pasditën në atë zonë pohoi se dy herë janë rrezikuar nga aksidentet. "Kam rastisur duke ndenjur me shokët dhe dy herë na kanë ardhur furgonat tek muri ku rrimë, shumë afër nesh.

Ne kemi shpëtuar mrekullisht. Në orët e pasdites kalojnë të gjithë kamionët që vijnë nga Sllovenia dhe shpesh të tjerë. Duhet kufizues shpejtësie, të paktën të shpejtë fëmijët", u shpreh Sytkia. Një tjetër histori personale është ajo e Fatmir Kurtulajt. "Unë kam 4 fëmijë dhe gjëja më e paktë që duhet bërë janë kufizuesit e shpejtësisë. Kur dalin në orarë e shkollës, fëmijët kanë rrezik të madh. Unë duhet të dal dy herë dhe ta lidh punën për të marrë fëmijët vetëm për shkak se duhet të presin rrugën, sepse dalin në dy orare të ndryshme nga shkolla", deklaroi Fatmiri".

se.ni

Policia: Të pranishëm në konflikt, edhe dy persona të tjerë ende të paidentifikuar

Masakra në ish-Bllok, shpallet në kërkim miku i të dashurit të këngëtares Elvana Gjata

Klodiana Lala

TIRANË

Afro një muaj pas ngjarjes së ndodhur në ish-Bllok, ku mbeti i vrarë 29-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinaj me Elio Hato, policia e Tiranës ka shpallur në kërkim në lidhje me ngjarjen e rëndë edhe një tjetër person. Bëhet fjalë për Ajaks Boshnjakun, i cili pohohet të jetë mik i Ervin Matës, partnerit të këngëtares së njohur Elvana Gjata dhe që është i shpallur në kërkim për masakrën në ish-Bllok, burime nga policia bëjnë me dije se janë edhe dy persona të tjerë që kanë qenë të pranishëm në lokal në momentin e përplasjes, por që ende nuk janë identifikuar. Grupi hetimor po punon për të identifikuar se kush janë dy personat e tjerë që kanë qenë të pranishëm dhe që janë përfshirë në konfliktin, që përfundoi me një të vrarë dhe dy të tjerë të plagosur.

Ajaks Boshnjaku dyshohet të ketë qenë i pranishëm në lokalin "Monopol", ku ndodhi përplasja me armë zjarri



Ajaks Boshnjaku



Vendi ku ndodhi masakra

HETIMI

Në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në zonën e ish-Bllokut, burime nga policia bëjnë me dije se janë edhe dy persona të tjerë që kanë qenë të pranishëm në lokal në momentin e përplasjes, por që ende nuk janë identifikuar. Grupi hetimor po punon për të identifikuar se kush janë dy personat e tjerë që kanë qenë të pranishëm dhe që janë përfshirë në konfliktin, që përfundoi me një të vrarë dhe dy të tjerë të plagosur.

NGJARJA

Mbrëmjen e 4 tetorit të këtij viti, në lokal në pronësi të Redi Popeskut mbeti i vrarë Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinaj me Elio Haton. Viktima ishte truporë i Martinajt. Ndërkaq, vijnë të jenë në kërkim autori i vrasjes, komandoja Meviol Bilo, biznesmeni Ervin Mata, Fabio Allushi dhe së fundmi është lëshuar fletë arresti për Ajaks Boshnjakun. Ndërsa të arrestuar deri tani janë Ervis Martinaj, Elio Hato dhe Geldo Hoti.

I gjenden kokainë, çokolatë dhe kanabis në banesë, shpallet në kërkim 46-vjeçari

FIER - Një ditë pas sekuestërimit në Pikën Kufitare të Kakavijës së sasisë prej 3.5 kg kokainë, policia e Fierit ka shpallur në kërkim pronarin e automjetit, ku u gjet lëndë narkotike. Bëhet fjalë për 46-vjeçar Daniel Zeziraj nga fshati Kreshpan i këtij rrethi. Ndërkohë, blutë bëjnë me dije se gjatë kontrollit në banesën e tij janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe 2.3 kg lëndë narkotike në formën e çokolatës, 8 kg kanabis sativa, 10 gr kokainë dhe një peshore elektronike. "Në vijim të veprimeve të përbashkëta me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në DVP Gjirokastrë, specialistët për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier ushtruan kontroll në banesën e pronarit të automjetit, në të cilën u gjet lëndë narkotike e dyshuar kokainë. Në vijim të veprimeve të kryera u bë shpallja në kërkim e shtetasit D.Y. si edhe u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale 'Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike' dhe 'Prodhim dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotropëve', thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Dy ditë më parë, në Kakavijë u sekuestruan 3.5 kg kokainë. Droga që kishte si destinacion Greqinë u zbulua në një makinë "Mercedes Benz" me ngjyrë të zezë që drejtohej nga 46-vjeçari Selim Lazaj nga Patosi, i cili përfundoi në pranga.

Korrupsioni, ministrja e Gjonaj "shkrin" Inspektoratin e Mjedisit, shkarkohen 15 zyrtarë

Furtunë" në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit në Tiranë, ku shkarkohen nga puna 15 zyrtarë, mes tyre kryeinspektori, 8 inspektorë pyjorë dhe 6 inspektorë mjedisorë, për akte korruptive apo abuzime me detyrën. Rezultatet e Task Forcës Antikorruptioni i njoftoi si çdo javë ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, që është njëherësh koordinatore Kombëtare e Antikorruptionit. Gjonaj theksoi se pas denoncimeve apo informacioneve që qytetarët kanë dhënë në platformën e bashkëqeverisjes "shqipëriaedua.al", janë kryer kontrole dhe inspektime edhe Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Glliozheni" në Tiranë si dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor - Dega Rajonale Tiranë, ndërsa në total janë rekomanduar 36 masa disiplinore. Në raportin e përjavshëm, ajo e vuri theksin edhe te rezultatet e Policisë së Shtetit, e cila në bashkëpunim me organin e



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

prokurorisë kanë evidentuar 27 vepra penale në fushën e korrupsionit dhe abuzimit me detyrën nga ana e punonjësve të administratës publike dhe janë proceduar penalisht 37 autorë. Gjonaj sqaroi se është rekomanduar largimi nga detyra për kryeinspektorin e Inspek-

toratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit-Drejtoria Rajonale e Qarkut Tiranë si dhe për 8 inspektorë pyjorë dhe për 6 inspektorë mjedisorë të po këtij institucioni. Për këtë institucion janë rekomanduar gjithashtu edhe 13 masa të tjera disiplinore. Ndërko-

hë, në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Glliozheni" në Tiranë janë rekomanduar 8 masa disiplinore për stafin drejtues dhe administrativ të këtij institucioni. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Task Forcën Antikorruption ka dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë një raport lidhur me shkeljet e gjetura në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për një procedurë të prokurimit publik. Nga kontrolli kanë rezultuar veprime të dyshimta të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, çka ka bërë që raporti i kontrollit t'i dërgohet prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Permbuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :

a) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekorë me nr pasurie 144/25 në Zonën Kadastrale 3217 me nr prone volumi 2, Fq 195, me sip totale 1937 m2 e ndodhur në fshatin Rraskullaj , Gruemirëv, Malsi e Madhe . Cnimi për hapjen e ankandit është në vlerën 292,874 leke .

b) Trulli + Ndërtese e regjistruar në regjistrin hipotekorë me nr pasurie 15327 në Zonën kadastrale 3217, me nr prone Volumi 2, Fqpe 195 me sip totale 1900 m2, nga kjo Trulli 200 m2 , Ndërtese 50 m2 e ndodhur në lagjen Rraskullaj Gruemirë, Malsi e Madhe . Cnimi për hapjen e ankandit është në vlerën 199,180 leke

Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 05.11.2018 ora 16.16 në Zyren e përmbuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko - Fshatit Gjykatës së metit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

Shoqëria përmbartore JUSTITIA

Shoqëria përmbartore JUSTITIA shpall ankandin, faza III, për shitjen e pasurisë së paluajshme me këto të dhëna:

Trulli- Ndërtesë me sip. totale prej 250 m2, nga ku trulli 250 m2, dhe ndërtesë 101 m2, nr. pasurie G/ 383, Vol. 16/fq. 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. "Sheqir Madhi" Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi

Cnimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.276.000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) leke

Ankandi zhvillohet në datën 30.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbuesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

LOTARIA AMERIKANE KËSHILLAT E AMBASADËS

DASH: Jemi në dijeni të problematikës, po punojmë për të zgjidhur situatën

Lotaria amerikane, çfarë duhet të bëni kur hasni pengesa gjatë aplikimit

Ambasada: Vetëm prisni dhe tentoni sërish për të aplikuar

Voltiza Duro

Ata që dëshirojnë të jetojnë në Shtetet e Bashkuara kanë edhe 5 ditë afat për të aplikuar për Lotarinë Amerikane. Por ashtu siç është paralajmëruar edhe më parë, plotësimi i formularit në ditët e fundit, mund të shkaktojë mbingarkesë në sistem. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë, nëpërmjet një njoftimi në faqen e saj zyrtare bën me dije se në rastet kur kandidatët hasin një problem gjatë procesit të aplikimit, duhet të presin dhe të tentojnë sërish. "Departamenti i Shtetit është në dijeni që disa aplikantëve u shfaqet një mesazh gabimi kur përpiqen të kryejnë aplikimin për t'u regjistruar për Programin e Lotarisë DV-2020 ose për të kontrolluar statusin e tyre. Zyrtarët aktualisht po punojnë për të rregulluar këtë çështje. Nëse hasni një problem gjatë procesit të aplikimit për Lotarinë, lutemi provojeni më vonë", thekson ambasada amerikane.

Të gjithë aplikantët e Lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së. Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë që është i barasvlefshëm me arsimimin në të paktën një shkollë të mesme amerikane (4 vjeçare, me kohë të plotë, arsim i përgjithshëm). Diplomat e shkollës së mesme gjinnaz me kohë të plotë kualifikohen për lotarinë. Shkollat e mesme profesionale me kohë të plotë mund të kualifikohen nëse ato në thelb përputhen me kërkesat thelbësore të një të arsimi të mesëm me kohë të plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendimi përfundimtar do të merrret nga oficeri konsullor në ditën e intervistës për vizë. Diplomat e shkollës së mesme me kohë të pjesshme - pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose ato me korrespondencë, përfshirë programet pesë vjeçare ose programet e gjata (me kohë të pjesshme, pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose me korrespondencë) nuk kualifikohen për programin e lotarisë. "Edhe nëse ju keni mbaruar një pjesë të shkollës së mesme

KESHILLA

"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi juaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një mashtrimi.



APLIKANTET

Të gjithë aplikantët e Lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së.

PERZGJEDHJA

Përzgjedhja e aplikantëve bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Të gjithë aplikantët e DV-2020 duhet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2020 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV.

në sistemin pa shkëputje nga puna dhe pjesën tjetër në sistemin me kohë të plotë, kjo diplomë nuk kualifikohet për programin e lotarisë. Diplomat universitare kualifikohen për programin e lotarisë së DV-së", thotë ambasada. Ndërkohë aplikantët që nuk përbushin kriterin e arsimimit, duhet të përbushin kriterin e përvojës në punë për dy vjet në një profesion që kërkon të paktën dy vjet trajnim apo përvojë brenda një periudhe pesëvjeçare menjëherë para aplikimit. Vetëm disa profesione specifike kualifikohen për programin e Vizave të Shumëllojsh-

mërisë. "Për t'u kualifikuar për një vizë të lotarisë mbi bazën e eksperiencës së punës, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në Përgatitjen Profesionale Specifike (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart. Profesione të cilat kualifikuese të DV-së janë të renditura në Bazën e të dhënave të Departamentit të Punës O*Net Online Database", theksojnë ekspertët. Të gjithë ata që do të bëjnë regjistrimin e DV-2020 duhet të plotësojnë edhe informacionin mbi statusin aktual martesor si:

i/e pamartuar; i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime nuk është qytetare amerikane, apo me green card; i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetare amerikane, ose me green card; i divorcuar; i ve, ose i ndarë ligjrisht. Mospërfshirja e një bashkëshorti/eje ekzistuese në datën që do të dorëzoni aplikimin tuaj është shkak për skualifikim dhe refuzim të vizës. Nëse bashkëshorti/ja juaj është qytetar Amerikan apo Banor i Përhershëm i Ligjshëm, mos e përfshini atë tek aplikimi juaj. Një bashkëshort i cili tashmë është një qytetar Amerikan apo një banor i ligjshëm i përhershëm nuk do t'kërkojë? dhe as nuk do t'i lëshohet një vizë DV. Ndaj, nëse zgjidhni opsionin "i martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetare amerikane, ose me green card" tek aplikimi juaj, sistemi nuk do t'ju kërkojë të vendosni informacionin për bashkëshortin/en. Kandidatët duhet të renditin emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, dhe shtetin e lindjes për të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç në ditën e regjistrimit elektronik, pavarësisht nëse ata jetojnë apo jo me aplikuesin, apo s'kanë ndërmend ta shoqërojnë në Shtetet e Bashkuara.

PERZGJEDHJA

Përzgjedhja e aplikantëve bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Të gjithë aplikantët e DV-2020 duhet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2020 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV. Kontrolli i Statusit të Regjistruarve do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të E-DV eëe.dvlottery.state.gov duke filluar nga 7 maji 2019 deri t'paktën më 30 shtator 2020.

MASHTRIMET

"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi juaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një mashtrimi. Vitet e shkuara, aplikantët fitues njoftoheshin nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Ken-

tucky (QKK) me anë të postës, JO me e-mail dhe të përzgjedhurve u jepeshin udhëzimet se si të vazhdonin në hapet e mëtejshëm të procesit. QKK-ja nuk ju kërkon juve t'u dërgoni para (të holla) atyre, apo ndonjë Ambasade tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A.) me postë apo nëpërmjet shërbimeve si Western Union", bën me dije ambasada. Vetëm aplikantët e përzgjedhur njoftohen nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK). Asnjë organizatë tjetër apo kompani private nuk është e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për të njoftuar aplikantët e DV-së për përzgjedhjen e aplikimit të tyre si fitues, apo të hapave të mëtejshëm në procesimin e aplikimit për vizë. "Disa adresa interneti mund të tentojnë t'ju orientojnë duke ju bërë të mendoni që ato janë adresat zyrtare të internetit për Lotarinë e Vizave të Shumëllojshmërisë. Ato mund të tentojnë t'ju kërkojnë të paguani për shërbime si formulari dhe informacionet, të cilat janë falas në adresat e internetit të Departamentit të Shtetit dhe të Ambasadave. Disa shoqëri kërkohen pagesa për të plotësuar formularin e aplikimit për Lotarinë e Vizave të Shumëllojshmërisë", bën me dije ambasada.

Bursa mbulon udhëtimin, shkollimin, dhomën, siguracionin, një pagesë të vogël mujore dhe librat

SHBA: Bursa për studentët, si të aplikoni

Ambasada: Kushti, të keni mbaruar së paku vitin e parë në fakultet

Ambasada amerikane ka publikuar dhe udhëzimin për të gjithë studentët shqiptarë që janë të interesuar për të studiuar me bursë të plotë përtej Atlantikut. "Aplikimet për Programin Global UGRAD 2018-2019 janë hapur! Global UGRAD është një program shkëmbimi i pavarur, i konceptuar për t'i ekspozuar studentët ndaj sistemit arsimor, shoqëror dhe kulturor amerikan. Filloni aplikimin tuaj! Afati i fundit është 31 Dhjetor, 2018", shkruan ambasada amerikane në një status në "Facebook".

Programi Global UGRAD është një program i financuar nga Departamenti i Shtetit, i cili jep bursa për studentë të nivelit universitar në 55 vende të botës. Studentët caktohen në kolegje dhe universitete në të gjithë Amerikën, ku marrin pjesë në një semestër të nivelit parauniversitar pa diplomë. Bursa mbulon udhëtimin, shkollimin, dhomën, siguracionin për aksidente/sëmundje, një pagesë të vogël mujore, dhe shpenzime për libra. Pjesëmarrësit jetojnë në konvikte me bashkëmoshatarët e tyre amerikanë ose në banesa me familje amerikane. Global UGRAD është një program shkëmbimi i pavarur, i konceptuar për t'i ekspozuar studentët ndaj sistemit arsimor, shoqëror dhe kulturor amerikan.

Të gjithë studentëve u kërkohet të marrin pjesë vullnetarisht në aktivitetet e shërbimit komunitar, si dhe të marrin pjesë në aktivitetet të zhvillimit profesional si pjesë e programit Global UGRAD. Studentët largohen nga Amerika me idenë për t'u bërë udhëheqës në profesionet dhe komunitetet ku jetojnë. Studentët që kanë mbaruar programin Global UGRAD mund të aplikojnë për programin Fulbright, të përfitojnë specializime të rëndësishme ndërkombëtare, dhe të punojnë në biznese ose administratë në vendet e tyre. Konkurrenca për programin është shumë e lartë dhe në bazë merite. Finalistët do të përzgjidhen në bazë të rezultateve akademike, aftësiave drejtuese, dhe përgatitjes së tyre për të studiuar në Shtetet e Bashkuara.

FUSHAT E STUDIMIT

Global UGRAD është i hapur për të gjitha fushat e studimit dhe nuk është diskriminues ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, fesë, etnisë, ose paftësisë fizike.

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM

Programi Global UGRAD



NUK KUALIFIKOHEN PËR BURSE NE SHBA

Personat në kushtet e mëposhtme nuk kualifikohen për programin Global UGRAD: Qytetarë amerikanë dhe banues të përhershëm në Shtetet e Bashkuara. Personat që aktualisht studiojnë, jetojnë, ose punojnë jashtë vendit të tyre. Punonjës vendas të misioneve amerikane, të cilët punojnë për Departamentin e Shtetit.



është i hapur për këdo që është:

Mbi 18 vjeç

Shtetas shqiptar, aktualisht rezident në këtë shtet

Të ketë mbaruar vitin e parë të universitetit përpara se të fillojnë programin Global UGRAD

I regjistruar si student në çdo universitet të akredituar, publik ose privat, dhe ka të paktën një semestër për të kryer në vendin e tij në përfundim të programit Global UGRAD; Programi Global UGRAD nuk mund të konsiderohet si semestër përmblyës për një student universiteti.

Njohuri të mira të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (Një program trajnimi për përmirësimin e gjuhës angleze, mundësohet për disa finalistë); të aftë për të filluar studimet në Shtetet e Bashkuara në gusht 2018 ose janar 2019 (kandidatët e zgjedhur nuk mund të fillojnë me vonë se këto data)

Të ligjëshëm për t'u pajisur me vizën amerikane për studentët (J-1) që nevojitet për

këtë program

Të ndërgjegjshëm për t'u kthyer në vendin e tyre pas përfundimit të programit

JO TË KUALIFIKUESHËM

Personat në kushtet e mëposhtme nuk kualifikohen për programin Global UGRAD

Qytetarë amerikanë dhe banues të përhershëm në Shtetet e Bashkuara

Personat që aktualisht studiojnë, jetojnë, ose punojnë jashtë vendit të tyre

Punonjës vendas të misioneve amerikane të cilët punojnë për Departamentin e Shtetit dhe/ose për Agjencinë Ndërkombëtare të Zhvillimit (USAID); punonjësit janë, gjithashtu, të pakualifikuar për një vit pas mbarimit të kontratës së punës;

UDHËZIME PËR APLIKIMIN

Një aplikim i plotë duhet të përmbajë:

Aplikimin

Një ese

Kopje të pasaportës biometrike ose kartës së identitetit

GLOBAL UGRAD

Programi Global UGRAD është një program i financuar nga Departamenti i Shtetit, i cili jep bursa për studentë të nivelit universitar në 55 vende të botës. Studentët caktohen në kolegje dhe universitete në të gjithë Amerikën, ku marrin pjesë në një semestër të nivelit parauniversitar pa diplomë. Bursa mbulon udhëtimin, shkollimin, dhomën, siguracionin për aksidente/sëmundje, një pagesë të vogël mujore, dhe shpenzime për libra.

AFATI

Afati i fundit është 31 Dhjetor, 2018 ora 11:00PM (ora shqiptare). Mos përdorni shkronja të veçanta / pikësime. Siste mi një vetëm alfabetin anglez. Shiheni me kujdes dhe njëherë aplikimin! Klikoni "dërgo" vetëm nëse jeni 100% të sigurt për ta bërë. Deri në këtë moment klikoni "ruaj" Procesi i regjistrimit kërkon konfirmim të llogarisë tuaj. Do të merrni një e-mail me udhëzime dhe një link për t'u regjistruar.

vlërësimit

Aftësia në gjuhën angleze

Nuk kërkohet të jepet testi i TOEFL gjatë kohës së aplikimit. Kandidatëve të përzgjedhur do t'u kërkohet të japin testin zyrtar të TOEFL. Programi do të mbulojë shpenzimet e testit zyrtar.

UDHËZIMET E APLIKIMIT

Udhëzimet hap pas hapi për të plotësuar aplikimin do t'i gjeni këtu (PDF 791 KB).

Për t'u regjistruar për programin Global UGRAD dhe për të plotësuar aplikimin përdorni Google Chrome dhe Mozilla Firefox. Nuk rekomandojmë të përdoret telefon celular ose Internet Explorer.

Kërkohet që kandidatët e interesuar TË APLIKOJNË ONLINE!

Nxiti! Afati i fundit

është 31 Dhjetor, 2018 ora 11:00PM (ora shqiptare).

Mos përdorni shkronja të veçanta / pikësime. Siste mi një vetëm alfabetin anglez.

Shiheni me kujdes dhe njëherë aplikimin! Klikoni "dërgo" vetëm nëse jeni 100% të sigurt për ta bërë. Deri në këtë moment klikoni "ruaj"

Procesi i regjistrimit kërkon konfirmim të llogarisë tuaj. Do të merrni një e-mail me udhëzime dhe një link për t'u regjistruar.

Përzgjidhni aplikimin Global UGRAD 2018 dhe klikoni "regjistruhu"

Klikoni: Plotësoni aplikimin online

Për pyetje të tjera, ju lutemi, shkruani në: CultureandEducationTirana@state.gov



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BANKA E SHQIPERISE

DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje dhe aksesore të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,718,400 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfytuesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje dhe aksesore të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 03 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Njoftim për shitje me ankad

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. në bazë të numrit 567/568 të K.Pr. Civile do të zhvillojë ankandin e parë për pasuritë e debitorit S. Shera, dhe O. Shera. Pasuria që shitet në ankad përbëhet nga: "Dyqan" me numër pasurie 6/279, Vol. 37, Fq.64, ne Z.K.Nr. 8350, me sipërfaqe 35 m2, e në Zvrrp Tiranë. Ankandi fillon me çmimin fillestar në masën 36.400 Euro "Dyqan" me numër pasurie 6/279, me Z. Nr. 8350, me sipërfaqe 4.8 m2, në Zvrrp Tiranë. Ankandi i pasurisë "Dyqan" fillon me çmimin fillestar në masën 3.840 Euro Ankandi do të zhvillohet në datë 12.11.2018 prej orës 15:00 në selinë e shoqërisë Bulv "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit mund të paraqiten ose të kontaktojnë tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit lir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

Altin Avdyli, pjesë e "grupit të Shijakut", që u arrestua tek "Vol-Vo 4"

Përgjimet e reja të Dakos me të arrestuarin: Ik pa merak

Kryebashkiaku i Durrësit bisedon me "Niçen"

Pas përgjimeve të publikuara një javë më parë lidhur një bisedë të zhvilluar mes kryetarit të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako me Altin Avdylin (Niçja) një prej personave të arrestuar gjatë operacionit "Vol-Vo 4" kanë dalë në dritë fakte të reja. Emisioni "Të Paekspozuarit" në "News 24" publikoi mbremë materiale të reja mbi dosjen 339. Bëhet fjalë për një përgjim të datës 20 shkurt të vitit 2017, saktësisht biseda është zhvilluar në orën 17:26. Në përgjim sipas TPZ përfshihet kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, teksa komunikon me Altin Avdylin (Niçja) dhe i premon se do t'i zgjidhë diçka, prandaj nuk duhet të merakoset. Biseda mes Dakos dhe Avdylit zhvillohet me tone mjaft të përzemërta.

BISEDA E TRETE

0698967XXX: Hë Gjushi!
0692099300: Hë Niçe!
0698967XXX: Hë vlla!
0692099300: Hë se jam duke fol me atë, mos e ki merak, ç'ke ti, o nesër... Këto ditë do ta mbaroj unë mos e ki merak?

0698967XXX: E të lutem!
0692099300: Ik pa merak.

Pak ditë më parë u publikuan dy biseda të tjera Dako-Avdyli. Biseda e parë është zhvilluar më datë 27 qershor në orën 11:08 para-dite, ku thirrja bëhet nga numri 069 20 99 300 drejt numrit 069 89 67 XXX dhe zgjat 1 minutë e 3 sekonda. Biseda mes Avdyllaj dhe Dakos është zbardhur më 23 tetor 2017. Në dokumentin e Prokurorisë së

PERGJIMET

Pak ditë më parë u publikuan dy biseda të tjera Dako-Avdyli. Biseda e parë është zhvilluar më datë 27 qershor në orën 11:08 para-dite, ku thirrja bëhet nga numri 069 20 99 300 drejt numrit 069 89 67 XXX dhe zgjat 1 minutë e 3 sekonda. Biseda mes Avdyllaj dhe Dakos është zbardhur më 23 tetor 2017.



Kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako

VANGJUSH DAKO

Kryebashkiaku i Durrësit u justifikua pak ditë më parë për bisedën e tij me Altin Avdylin duke thënë se ai bisedon me shumë njerëz dhe i falënderon për kontributin në zgjedhje. Dako tha se i kishte duart e pastra "akulllore" dhe shtoi se nuk sheh asnjë arsye pse duhej të jepte dorëheqjen.

Përgjithshme thuhet gjithashtu se personi që përdor telefonin e përgjaur është pikërisht numri 069 20 99 300, që i përket kryetarit të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Biseda e dytë është bërë mes Altin Avdyllaj dhe një personi tjetër që i kërkon t'i thotë Dakos të paguajë një familje që ka votuar për ta në

zgjedhje.

BISEDA E PARË

Niçja: Hë kryetar, hë vllai.
0692099300: Niçe, ku je?
Niçja: Këtu vërdallë...
0692099300: Ku është As-triti?
Niçja: Ka lëviz një çikë.
0692099300: Ku ka lëviz?
Jashtë Durrësit?
Niçja: Eh... ç'a ka? Ka ndonjë gjë?
0692099300: Po jo mo, doja

ta takojsha, ta falenderojsha, ta pyesja një çikë.

Niçja: Po, po ku je ti? Të vij të takoj...
Njësoj është, si ai si unë, e di që jemi një.
0692099300: Po mirë mo mirë, por doja ta takoj... kanë pi ato.
Niçja: Po, e di po kanë lëviz... Me të taku një çikë unë ty!
0692099300: Unë tani jam

duke ardh nga... rrugës... rrugës...

BISEDA E DYTË

Biseda e dytë është bërë nga numri i telefonit 069 56 39 642 (i paidentifikuar) drejt numrit 0898967XXX (Altin Avdyllaj) në orën 20:06 të mbremjes me kohëzgjatje 31 sekonda një ditë para zgjedhjeve të 25 qershorit.
Niçja: Të marr unë se jam me rob pra...

Alo, ç'a po bën?
Niçja: Të marr unë se jam me rob të thashë!
Ku je? Je andej nga shftrat, ku ishe?
Jo! Jo! Jo!
Kam ca me mbiemër Kurti, kam zonjën këtu...
... po deshe...
Niçja: ...mirë...
6 veta janë!
Niçja: Hajt se të marr unë!
Thuaj Vangjushit t'i japim ndonjë lek, që të votojnë!

Deputeti Alket Hyseni ka publikuar të dhënat: Duhet të kandidojë për mandatin e dytë

Sondazhi i PS-së: Erion Veliajn e votojnë 63% e qytetarëve të Tiranës

Nëse zgjedhjet ven do të mbaheshin tani, atëherë 63 për qind e qytetarëve të Tiranës do të votonin kryetarin aktual të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajn. Këto janë të dhënat që zotëron Partia Socialiste pas një sondazhi të brendshëm që ajo ka bërë në Tiranë. Rezultatet janë bërë të ditura nga deputeti socialist, Alket Hyseni, gjatë një interviste në "ReportTV", ku dhe ka deklaruar se kryebashkiaku aktual gëzon një mbështetje më të madhe edhe se 3 vite më parë, kur konkurroi për herë të parë për kryetar të Bashkisë së Tiranës.

PËR KANDIDIMIN

"Zoti Veliaj duhet të kandidojë patjetër për një mandat të dytë, pasi shumë herët në mëngjes dhe deri vonë është në shërbim të qytetarëve të Tiranës. Pastaj do të jetë populli që do e vlerësojë. Veliajn e kemi kandidatim më të mirë të mundshëm", shtoi Hyseni.



"Sondazhet e nxjerrin mbi 63%. Nëse do të votohej këtë fundjavë, Veliaj do të merrte 63%, ndërsa opozita 30% e ca", tha deputeti Alekt Hyseni, i cili në fakt është edhe një nga pjesëtarët e grupit që merret me çështjet zgjedhore në Partinë Socialiste. Ndaj, ai ka theksuar se Veliaj është kandidati më i mirë që Partia Socialiste mund

të ketë për Tiranën, duke konfirmuar në këtë mënyrë rikandidimin e tij për një mandat të dytë. "Zoti Veliaj duhet të kandidojë patjetër për një mandat të dytë, pasi shumë herët në mëngjes dhe deri vonë është në shërbim të qytetarëve të Tiranës. Pastaj do të jetë populli që do e vlerësojë. Veliajn e kemi kandidatim më të

mirë të mundshëm", shtoi Hyseni. Gjithsesi, bëhet fjalë për një sondazh partiak dhe nuk dihet nëse ai përfaqëson vërtetë bindjen e qytetarëve të Tiranës. Kjo, pasi një sondazh i tillë jo vetëm që është partiak, por është bërë vetëm me një kandidat, pa pasur përballë një emër që mund të përfaqësojë opozitën.
Hyseni nuk është i pari

deputet socialist që ka dalë hapur në mbështetje të Veliajt për të kandiduar për një mandat të dytë për Bashkinë e Tiranës. Vetëm tri ditë më parë ishte një tjetër eksponent i rendësishëm i socialistëve, ministri i dorëhequr, Fatmir Xhafaj iu bashkua turit të Veliajt në bazë, duke deklaruar se Veliaj kërkon një mandat të dytë jo për të

qëndruar në atë karrige, por për të shërbyer dhe për ta çuar përpara misionin e tij për transformimin e Tiranës. "Ka njerëz që ulen në një karrige dhe janë të kënaqur se kanë kapur një karrige, ka njerëz që marrin pushtet dhe janë të lumtur që janë të pushtetshëm, ka njerëz që vijnë për të shërbyer, që kanë një mision, që duan të lënë një gjurmë përmes mundësisë që u jep pushteti dhe ky është Erion Veliaj!", u shpreh Xhafaj. Por, ndërsa socialistët duket se nuk kanë dyshime për kandidaturën që do t'i përfaqësojë në Tiranë, në anën tjetër opozita vazhdon të mbetet hermetike në këtë drejtim, pavarësisht se ka hedhur disa kandidatura për t'u testuar në opinionin publik.

Kryeministri në konferencë: I vetmi institucion që nuk është anatemuar

Rama lavdëron Bankën e Shqipërisë: Ka qenë pikë referimi për të gjithë

Ahmetaj: 4.3% rritje ekonomike në 2019, më e larta në rajon

Kryeministri Edi Rama u shpreh se Banka e Shqipërisë është i vetmi institucion që nuk është anatemuar dhe përbën një mbështetje shumë solide dhe garanci të fortë në raport me qeverinë.

Kryeministri theksoi se "BSH është ndoshta i vetmi institucion që rrezaton një qëndrueshmëri konstante në të gjithë periudhën e ekzistencës së vet, pas rënies së komunizmit".

"Nëse nuk i kam bërë gabim llogaritë, BSH është i vetmi institucion në këtë vend që nuk është anatemuar nga njëra palë për llogari të kacakafjes me palën tjetër politike. Kjo mjafton për ta përcaktuar BSH si një qendër të rëndësishme dhe të pakontestueshme gravitativ që pa diskutim është meritë e ekipit të drejtimit, bordit dhe guvernatorëve njëri pas tjetrit", tha Rama.

Për të ilustruar rolin e Bankave Qendrore në realitetin e sotëm, kryeministri Rama u rikthye në periudhën e 50 viteve më parë.

"50 vite më parë kur BE sapo kishte dalë nga pelenat dhe duhet të provonte rezultatet gjysmë shekullit që kaloi, Banka e Suedisë pati organizuar një konferencë me të njëjtin pyetje që sot Shqipëria ia bën vetes: Banka qendrore përballë sfidave. E parë me sytë e 50 viteve më pas, politikant monetare i kanë kapërcyer kufijtë të ndërlidhura dhe janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Sot në një vend si Shqipëria është ngritur pyetja e integritimit evropian me tërësinë e kushteve. Banka qendrore duhet t'i japë një përgjigje kësaj pyetje, duket pyetje dhe thjeshtë, por është komplekse. BSH ka pasur një rol pozitiv në përballjen me përdurën pas krizës duke qenë në vijimësi pikë referimi për të gjithë. BSH është i vetmi institucion që nuk është anatemuar nga njëra palë për llogari të kacakafjes me palën tjetër. Kjo tregon se BSH është një qendër e

EDI RAMA
Kryeministri vlerësoi rolin e Bankës së Shqipërisë dhe punën për të përballuar pasojat në momente të caktuara dramatike, ndërsa tha se BSH ka pasur një rol jashtëzakonisht pozitiv edhe në përballjen me periudhën pas krizës, duke qenë në vijimësi një pikë referimi për të gjithë.



Kryeministri Edi Rama

ARBEN AHMETAJ
Ministri i Financave tha se "Kreditë me probleme kanë shkuar nga 24% në vitin 2014 në 13.3% në 2018 dhe vazhdojnë të ulen. Falë këtyre ndërhyrjeve nga më domethënëset në sistemin financiar shqiptar, sot sistemi është shumë i sigurt dhe më i pajisur me mjete për të përballuar situata të vështira".

nga punonjësit publikë të pensionistët, apo shtresat në nevojë, bizneset, bankat e kështu me radhë.

Faktikisht për shkak të përgjegjshmërisë së qeverisë dhe të gjithë aktorëve, duke përfshirë edhe Bankën e Shqipërisë, kriza greke u la pas tani, është kthyer në një përallë të së kaluarës. Në 2012 nuk ishte aspak një përallë, ishte një realitet i mundshëm".

Ministri Ahmetaj tha se "përfitoj në çdo rast të tillë të përmend fjalët e kryeministrit Rama në prezantimin e programit të qeverisë së shtatorit të 2013; "Përpara kemi një shkëmb, mbrapa kemi një gropë". Që do të thotë që kishim vetëm një rrugë dhe atë rrugë tashmë ne, ju qytetarët e kanë parë e kanë provuar mes dhimbjes reformash, suksesesh duke lënë gropën mbrapa dhe shkëmbin të dërrmuar".

Duke përmendur reformat e kryera nga qeveria, Ahmetaj u shpreh se "u reformua sektori tërësisht energjetik, i cili ishte totalisht në kolaps, u ndërhy në reformat pensioneve duke e shndërruar skemën në një projektion të qëndrueshëm, reforma administrative territoriale nga 374 njësi në 6 njësi, duket si aritmetikë e thjeshtë, në fakt, ka qenë një ushtrim politik dhe administrativ tejet i guximshëm dhe i vështirë, si dhe reformat në arsimin e lartë".

Nuk mund të lë pa përmendur vijoi ai, reformat e financave publike ku së bashku me FMN, Bankën Botërore, Komisionin, sot ne numërohem në vendet me transparencë të kënaqshme, të lartë në financat publike.

pakundërshtueshme e gravitetit dhe është një trashëgimi e çmuar. BSH përbën një mbështetje shumë solide dhe garanci të fortë në raport me qeverinë tonë dhe me çdo qeveri. Sot është ulur niveli i kredive të këqija në krahasim me vitet e kaluara", tha Rama.

Rama vlerësoi rolin e Bankës së Shqipërisë dhe punën për të përballuar pasojat në momente të caktuara dramatike, ndërsa tha se BSH ka pasur një rol jashtëzakonisht pozitiv edhe në përballjen me periudhën pas krizës duke qenë në vijimësi një pikë referimi për të gjithë.

MINISTRI I FINANCAVE

Rritja ekonomike në Shqipëri në vitin 2019 do të arrijë në 4.3%, që mendohet të jetë më e larta në rajon.

Kështu deklaroi sot ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj, në

konferencën vjetore "Politika monetare, integrimi ekonomik dhe normaliteti i ri", ku është i pranishëm kryeministri Edi Rama, guvernatori i Bankës së Shqipërisë Gent Sejko, etj.

"Ekonomia shqiptare rritet në nivelet 4%. Dikush thotë a mjafton. Ky është një debat që nuk ka për të mbaruar kurrë. 7% mbase nuk do të mjaftonte, 10% ndoshta për të konverguar sa më shpejt me nivelin e BE-së nuk do të mjaftonte, por, kur e krahasoj me 0.8% në 2013, pas risikut të një kolapsi total, sigurisht që 4% është katër herë më shumë", nënvizoi Ahmetaj.

Ministri Ahmetaj theksoi se "rritja ekonomike është mbështetur në mënyrë të balancuar si te konsumi i popullatës ashtu edhe tek investimet në ekonomi, shtimi i aktivitetit ekonomik, ndryshe ndodhte në vitet para 2013, është më në fund

shoqëruar me rritje punësimi.

Ministri tha se "sërish nuk do të ndalem asnjëherë së përsërituri se besoj se çështja e punësimi është çështja më rëndësishme e diskutimit mes qeverive dhe aktorëve të tjerë në ekonomi".

"Shumë aspekte të realitetit ekonomik kanë ndryshuar pas vitit 2008 qoftë nga pikëpamjet e infrastrukturës financiare apo të sjelljes së aktorëve ekonomikë si institucionale ashtu edhe individëve", shtoi ai.

Lidhur me investimet e huaja, Ahmetaj tha se "në vitin 2018 investimet e huaja direkte pritet të jenë në nivele të kënaqshme. Më besoni se të paktën në aspektin nominativ do të jenë shifra rekord. Nuk ishte e lehtë të vinim në këtë realitet të sotëm ekonomik.

Qeveria shqiptare ndërmori një sërë masash të gu-

imshme dhe jo të lehta për të evituar situatën e vështirë ku ndodhje vendi në 2013".

Ahmetaj tha se "efektet e krizës së 2008 u transmetuan në ekonomi të ndryshme përmes kanaleve të ndryshme. Shqipëria fatmirësisht nuk u përfshi në një recesion klasik pas krizës së 2008, por degradimi i performancës së aktiviteteve ekonomik u shfaq vit pas vit duke kulmuar në gjendjen e vitit 2013, 2012. Në 2012 kur Shqipëria konsiderohej në kulmin e varfërisë së vet. Dhe në 2013 kur situata e financave publike dhe ekonomike ishte në atë gjendje që edhe na surprizoi edhe nuk na surprizoi, kur skanuan realitetin".

"Ne jemi sot paqetë në një realitet të ri, ekonomia shqiptare e ka lënë pas vitin e vështirë 2013 dhe pasojat që eventualisht do të shihnim dhe ndjenim të gjithë

Guvernatori Sejko: Sfidat kryesore me të cilat haset Banka e Shqipërisë



sojë e një kombinimi faktorësh: ngadalësimi i produktivitetit dhe i ritimit të inovacionit; trendet e pafavorshme demografike në vendet e zhvilluara; apo dhe rrethimi i kursimeve nga vendet në zhvillim drejt atyre të zhvilluara. Kjo rënie sjell reduktimin e hapësirave për politikë monetare stimuluese konvencionale në të ardhmen. Lidhja midis kërkesës agregate dhe normës së inflacion-

it është zbehur në horizontin afatshkurtesë e afatmesëm, si pasojë e zhvillimeve në tregjet e punës dhe e integritimit në rritje të ekonomisë botërore. Ky fenomen rrit koston e veprimit të politikës monetare. Po ashtu, inovacioni financiar dhe ndërgjegjësimi në rritje i ndërlidhjes midis stabilitetit ekonomik e monetar, nga njëra anë dhe stabilitetit të sistemit financiar nga ana tjetër, kanë

reduktuar hapësirat e veprimit të instrumenteve konvencionale të politikës monetare" - tha Sejko.

Ai nënvizoi se konsensusi mbifizionominë e "normales" së re të politikës monetare duhet të ruajë tri elemente esenciale të saj.

"Së pari, shmangia e objektivave të shumëfishtë, apo të paqartë e jotransparentë, mbi politikën monetare. Ky parim do të ruante besuesh-

mërinë e politikës monetare, si një parakusht i rritjes së efektivitetit dhe i reduktimit të efekteve anësore të ndërhyrjes së saj.

"Së dyti, njohja e limiteve që ka politika monetare, si në horizontin afatshkurtesë e afatmesëm, ashtu dhe në atë afatgjatë.

"Së treti, dizajnimi i gamës së instrumenteve në përdorim të politikës monetare duhet të kujdeset për shmangien e rrezikut në bilancin e bankës qendrore, çka do të ndikonte negativisht pavarësinë e tyre.

Në një këndvështrim më specifik, realiteti i sotëm ekonomik, monetar e financiar, paraqitet veçanërisht sfidues për politikën monetare. Ky realitet emërtohet dhe si "normalja" e re e politikës monetare. Më lejoni të identifikoj disa prej këtyre sfidave".

Ishte kjo kryefjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko në hapjen e Konferencës Vjetore të BSH-së.

"Normat natyrore të interesit paraqiten në rënie, potencialisht si pa-

'Çmendi' botën me receta, sukcesi i shqiptarit në restorante dhe çmimet e fituara

Rrëfëhet Ravajol Hasani:

Unë, kuzhinieri i Rihannës dhe presidentit të Kanadasë, ja pjatat që iu përgatis

"Jamie Oliver më ka vlerësuar si ambasadori i tij në Shqipëri"

Egla Xhemali

I lindur në Memaliaj, megjithëse prej kohësh jeton mes Greqisë dhe Qipros, Ravajol Hasani është shefi i kuzhinës shqiptar, i cili me talentin e tij ka mahnitur shefat më të mëdhenj të kulinarisë në botë. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", ai rrëfen vështirësitë e emigrimit drejt Greqisë, ku shprehet se shpeshherë është nënvlerësuar e përbuzur vetëm se ishte shtetas shqiptar. Ai tregon plot nostalgji kontaktet e para me kuzhinën, që do të bëhej më vonë dashuri dhe një vend i pandarë për të. Pasionin për gastronominë, Ravajoli e ka treguar me punën e tij, duke e ushtruar profesionin në restorantet më të mëdha në rajon e në Evropë. Kjo ka bërë që ai të vlerësohet me një sërë çmimesh si "Kapelja e Artë" dhe "Luga e Argjendtë". Gjithashtu, ai është caktuar nga vetë shefi i kuzhinës me famë botërore, Jamie Oliver, si ambasadori i tij në Shqipëri. Ravajol Hasani tregon se gjatë rrugëtimit të tij ka pasur momente të bukura, por edhe të vështira, të cilat e vlin në sfidë me veten. Kur një klient nuk kënaqet plotësisht nga pjata e tij, për Hasanin është një mision për përmirësimin dhe gjetjen e problemit të përgatitjes së ushqimit. Edhe pse i ri në moshë, ai ka një eksperiencë vërtet të madhe e të admirueshme në kuzhinë, vlerësimi i tij nga shefa të mëdhenj të kuzhinës ka bërë që të punojë në restorante ku shkojnë VIP-a të ndryshëm nga e gjithë bota. Ravajoli i ka shërbyer ushqim këngëtares me famë botërore Rihana, presidentit të Kanadasë e shumë aktorëve të njohur. Për kuzhinierin më të njohur shqiptar, pavarësisht statutit shoqëror që mund të ketë një person, ushqimi do t'i përgatitet dhe



serviret me të njëjtën dashuri dhe përkujdesje.

Ju jeni larguar që në moshë të vogël nga Shqipëria në drejtim të Greqisë. Cilat janë momentet më të vështira të jetës suaj?

Emigrova para 15 viteve, kohë kur u futa në

kuzhinë, djalë i vogël, punoja 15 orë për një euro ora. Koha e emigracionit ishte shumë torturë, më shikonin si një gjë më poshtë, sepse isha emigrant nuk kisha të drejta ose një dorë, apo ndihmë që të ndërtojë veten dhe jetën. Duhej të kurseja

para studimit dhe shpenzimet personale sepse nuk të jepte njeri. Për të studiuar dhe për të arritur ëndrrën time duhej luftë, lodhje dhe sakrifica.

Si nisi kontakti i parë me kuzhinën?

Kontakti nisi që në moshën 16-vjeçare si pastruer në kuzhinë, atje kuptova që jeta ime filloi dhe do mbarojë në kuzhinë. Kuptova që atje do përfundoj dhe që u linda për këtë art.

Cilat janë bashkëpunimet më të rëndësishme që ju kenë bërë gjatë karrierës?

Bashkëpunimi me Jamie Oliver, ai donte të hapte restorantin e tij në Qipro, nën markën e tij dhe më zgjodhi si menaxherin e tij. Kam bashkëpunuar me Spiros Dossis, i cili është edhe personi që më tregoi rrugën, por që të bëheshe një shef i suksesshëm, duhet të punosh me shefa të suksesshëm.

Ju jeni vlerësuar me një sërë çmimesh në fushën e kulinarisë. Cilin prej tyre e konsideroni si më të rëndësishmin?

Viti 2016, për mua që një vit që unë nuk e prisja të

shpërblehesha me çmim. Unë u vlerësova si shefi më i mirë për vitin 2016. Mora "Kapelja e Artë" dhe "Luga e Argjendtë". Jamie Oliver më ka vlerësuar si ambasadorin e tij në Shqipëri. Kishte vite me shumë punë, lodhje dhe sakrifica, por kam stafin tim që më mbështet në çdo hap, dashuria e fansave në tërë botën dhe familjet e sime.

Në cilat vende apo shtete e keni ushtruar profesionin tuaj?

Shtetet janë shumta, duke filluar nga Greqia, Franca, Qipro, vendet skandinave dhe pothuajse në gjithë botën.

Keni punuar në restorante me shumë emër në rajon apo Evropë. Kush janë VIP-at që ju i keni shërbyer?

Restorantet janë të mëdhenj e me emër, po ashtu të vlerësuar me shumë çmime. Në fakt, VIP-at janë të ndryshëm dhe me shumë emër në botë, si në fushën e muzikës, modës, aktorë, por edhe politikanë. Kam gatuar para një viti në Kanada për presidentin e Kanadasë, Justin Trudeau. Po ashtu dhe për këngëtares Rihana dhe aktorin Hu Jackman e plot të tjerë.

Cila ka qenë pjata më e vështirë për t'u përgatitur?

Pjatat më të vështira janë ato që janë më delikatet, ato që prishen për një gradë temperature, digjen ose ndahen. Ato që duan detaje në perfeksion. Këto ndodhen në kuzhinën franceze.

A ka pasur momente që keni dashur ta braktisni kuzhinën dhe të merreni me diçka tjetër?

Jo, në asnjë mënyrë nuk më ka shkuar në mendje të bëj një gjë tjetër. U linda në kuzhinë, jetoj me atë, aty marr ajër dhe frymë edhe kur jam me stafin tim, kur gëzohem dhe zemërohem, kur bie dhe ngrihem.

Gjatë karrierës suaj keni pasur ndonjë incident me ndonjë klient që nuk ka pëlqyer ushqimin tuaj?

Klientë të tillë kam pasur dhe do kem, pasi nuk mund të kënaqësh të gjithë. S'je magjistarë, sado i suksesshëm të jesh dhe i vlerësuar rëndësi ka që nga gabimet të mësosh e të punosh me kokën ulur dhe puna do tregojë të vërtetën.

Duke pasur parasysh eksperiencën tuaj në shumë shtete, si i shihni restorantet shqiptare në krahasim me vendet e tjera?

Këtu do bëhem pak i hidhur. Duhet shumë punë në Shqipëri në fushën e gastronomisë dhe kulinarisë. Duhet përpjekje dhe standarde, pasi ca gjëra janë shumë mbrapa. Po nuk u bëmë të gjithë një grusht, nuk do arrijmë kurrë të futemi në garën europiane të kulinarisë, as në tregjet e mëdha. Secili në një restorant ose hotel duhet të ketë standarde, të informohet ose të studiohet. E kemi për detyrë të japim cilësinë maksimale më të larta. Për të kuptuar këtë, duhet ta vëmë veten gjithmonë në vendin e klientit. Ushqimi që japim të kalojë në disa kontrole e në përgatitje të sakta, vetëm kështu do kemi harmoni dhe një biznes të suksesshëm.

Nëse do gatuanit për një person të veçantë për ju, çfarë piete do i servirnit?

Në gatime nuk bëj dalime nëse është i pasur ose i varfër, i bardhë apo i zi, politikan ose një kamerier. Të gjithë në restorantet e mia, nga pastruesja deri te menaxheri do ushqehet njësoj dhe me dashuri të njëjtë. Po të gatuaja një gjë të veçantë, do të ishte ëmbëlsirë.

Kush është idhulli juaj?

Idhulli im në gastronomi është Jamie Oliver, me të cilin edhe kam bashkëpunuar. Gjithashtu kam plot të tjerë që më pëlqejnë dhe i vlerësoj si Marco Pierre White, Joel Reducion, Paul Bocuse, Eric Frechon dhe Tommas Keller.



Dafina paralajmëron fansat, ja ç'ka në plan diva

Që nga vera, Dafina Zeqiri duket se është kthyer fuqishëm në muzikë dhe skenën shqiptare me koncerte dhe projekte të reja muzikore, me dy bashkëpunime mjaft të fuqishme me Lumi B dhe Noizy, të cilat kanë rezultuar suksese të vërteta. Hit pas hiti duket se Dafina nuk ka të ndalur dhe ka treguar se ka ende mjaft surpriza për fansat e saj. Nëpërmjet "Instastory"-t, Dafina ka treguar se ka gati dhe 5 projekte të reja. "Kur i ke nja pesë projekte dhe s'e di cilin të publikosh më përpara", ka shkruar në një publikim këngëtarja.



Bëni kujdes! Enca hodhi "bomën" për reperat shqiptarë

Nuk ka ditë që të mos dëgjojmë diçka nga Enca. Këngëtarja është mjaft aktive si me projektet e saj që kthehen menjëherë në hite, po ashtu edhe në rrjetet sociale në komunikimin që bën me ndjekësit e vet. Së fundmi, Enca ka vendosur të thumbojë reperët shqiptarë duke paralajmëruar vajzat që i kanë qejf. "Eëe sa sweet që janë këta artistët/reperat e dua një çik të mirë, të bukur, të urtë për me marr nuse dhe me mbyll në shtëpi derisa të vij dita që të martohemi...".

'Çika mos e humbisni kohën duke ndjekur një burrë, kënaquni dhe gjeni një burrë për shtëpi', ka shkruar Enca në Instastories.



"Balkan Contemporary Music Festival" nis edicionin e II

Balkan Contemporary Music Festival" e nisi edicionin II me mbremjen e muzikës sllovene. Programi festivalit dëshmon respektimin e parimit mbi të cilin është themeluar, pra një festival, i cili do të krijojë hapësira të për bashkëta përfaqësimi për muzikën e kompozitorëve të vendeve ballkanike. Nata e muzikës sllovene u materializua në interpretimin e flautistit Matej Grahek dhe pianistit Luca Ferrini, një duo kjo, tashmë e konsoliduar, që përfaqëson muzikën e kompozitorëve sllovenë në mjaft festivale dhe koncerte të ndryshme në mbarë botën. Dhe besoj se një nga arsyt kryesorë pse ky koncert vështirë se do të zvetënohet nga kujtesa e publikut pjesëmarrës, është pikërisht cilësia interpretative e artistëve të sipërpërmendur. Programi koncertit ishte konceptuar që në radhë të parë të paraqiste kompozitorë të rëndësishëm sllovenë, por edhe autorë botërorë, sikurse edhe vepra nga kompozitorë shqiptarë.

Cilësitë interpretative



të duos sllovene u shpaloën prej notave të para të Sonatës Nr. 14 të kompozitorit polak, Robert Muczynski. Një vepër e konceptuar me disa kohë dhe që rezonoi, sikurse dëshmuar edhe duartrokijtjet, mjaft mirë me pritshmëritë e të pranishmëve në sallë. Veprat e kompozitorëve sllovenë Pavle Merku dhe Aljzo Ajdic krijuan një atmosferë krejt tjetër dhe dëshmuar për bashkëjetesën e stileve të ndryshme në krijimin e muzikës sllovene, pavarësisht bashkëkohësisë së kompozitorëve. Në veprën e Ajdic, për flaut solo, u shpaloën më së miri cilësitë e flautistit Matej Grahek. Thjeshtësia me të cilën interpretonte pasazhet tejet të

vështira të krijojnë përshypjen se flautisti këtë vepër e kishte ekzekutuar së fundmi, ndërkohë që siç u shpreh edhe vetë, kishte mbi 5 vite pa e shfletuar. Të njëjtat aftësi interpretuese, artistët sllovenë i konfirmuan edhe në veprat e kompozitorëve shqiptarë dhe kjo u vërejt prej notave të para të veprës së Hajg Zacharian. Në origjinë vepra e Zacharian është kompozuar për violinë e piano, por përshatja për flaut dhe piano tingëlloi e freskët dhe po aq emocionuese sa varianti original i veprës. Interpretimi korrekt dhe pasionant i duos Grahek-Ferrini i falë një jetë të re kësaj vepre, që kurse përshatja për këtë formacion ishte një premierë botërore e realizuar mirë artistikisht dhe interpretuar krejt natyrshëm.

"Points of View III"... e Dorian Çenes, e rënditur e dyta në programin e koncertit menjëherë mbas veprës së Muczynski-t, të paraqiste një qasje estetike krejtësisht të ndryshme. Duoja e kishte trupëzuar veprën në mënyrë kaq org-

ganike, sa të krijohet ideja se po e interpretonte për të disatën. "Points of View III" e kompozuar fillimisht për klarinetë dhe piano, paraqiste vështirësi të konsiderueshme teknike dhe interpretuese, përgjithësisht për instrumentin e flautit. Gjithsesi, të gjitha këto vështirësi u paraqitën thuasje inekzistente dhe tingëllimi, sidomos i bashkëtingëllyeve tek flauti, u realizua në mënyrë mjeshtërore dhe profesionale. Artistë ia dolën që të funksiononin si një trup i vetëm, duke krijuar e realizuar mjaft mirë kontrpunktin organik, sidomos përsa i përket përafrimit timbrik, një elementi ky kaq i rëndësishëm për këtë vepër.

"Hatching aliens" e Ian Clarke mbylli programin e koncertit të duos sllovene. Një zgjedhje kjo e zgjuar e artistëve, që kurse vetë Clarke është flautist dhe ka ditur të krijojë pasazhe mjaft efektive për këtë instrument. "Balkan Contemporary Music Festival" në edicionin e tij të dytë është mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tiranës, ndërkohë që do të vazhdojë rrugëtimin e tij me mbremjen e muzikës maqedonase, që do të mbahet date 8 nëntor në sallën e Universitetit të Arteve.

Table with 4 columns: Name, ID, Name, ID. Lists names and their corresponding identification numbers in a grid format.

Table with 4 columns: Rank, Name, Surname, and Birth Date. It lists 1000 names in alphabetical order, including HAJDARI, DEKOVII, HOTAJ, GJIKAJ, etc., up to MEHILLI, XHESIANA.

Pangalos: Unë jam kundër! Edhe në SHBA ekzekutohen

Shpërthen ish-ministri i Jashtëm grek: Kaçifas ishte faqezi

Ditën e djeshme, ish-ministri i Jashtëm grek, Theodoros Pangalos, ka dhënë një intervistë të fortë për "Sky"-n grek, ku ka thënë se policia shqiptare ka vepruar mirë dhe drejt, në rastin e vrasjes së ekstremistit Konstandin Kaçifas. Ai tha se ishte kundër atyre që mbanin armë. "Mos harroni se ai kishte

THEODOROS PANGALOS

"Mos harroni se ai kishte armë, a e patë ju? Unë jam kundër këtij faqezi. Unë besoj se kushdo që ka armë në dorë duhet të qëllohet. Jam kundër këtij faqeziut. Ashtu siç ndodh edhe në SHBA, këta qëllohen në raste të tilla", - tha Pangalos.

armë, a e patë ju? Unë jam kundër këtij faqezi. Unë besoj se kushdo që ka armë në dorë duhet të qëllohet.

Jam kundër këtij faqeziut. Ashtu siç ndodh edhe në SHBA, këta qëllohen në raste të tilla", tha Panga-



Ish-ministri i Jashtëm grek, Theodoros Pangalos

los. Por deklaratat e forta të Pangalos kanë vënë në siklet gazetarët e televizionit. Ata ia mbyllën me

shpejtësi intervistën atij dhe mezi e lanë të përfundonte fjalën ish-ministri i Jashtëm.

Zëdhënisi i Erdogan: Forcat e armatosura s'do hezitojnë të veprojnë

Turqia paralajmëron me luftë Greqinë për detin

Konflikti për ishujt, grekët pretendojnë zgjerimin e ujërave territoriale

Pas "luftës" së ftohtë të pashpallur mes tyre, Turqia paralajmëron se do të kundërpërgjigjet ushtarakisht nëse Greqia nis zgjerimin e ujërave territoriale, sipas parimit të 12 miljeve. Deklaratën e bëri zëdhënisi i partisë së Presidentit Erdoan, i cili e konsideroi të rrezikshme përpjekjen e Athinës. "Kjo është një sjellje e rrezikshme. Hapësira që ata e njohin si "zona 7" është pjesë e shelfit tonë kontinental. Përgjigja e merituar do t'u jepet nga forcat tona të armatosura, që nuk do të hezitojnë të përmbushin kërkesën e Republikës së Turqisë". Athina e ka bërë të qartë qëndrimin e saj se për sovranitetin territorial nuk merr urdhra nga Ankaraja. Por ish-ministri i Jashtëm grek Theodoros Pangalos i bën thirrje qeverisë greke të tregohet e kujdesshme me çështjen e zgjerimit të hapësirës detare dhe marrëdhëniet me Turqinë. "Do thosha që nuk duhet të përplasemi me Turqinë. Është një forcë e madhe, duhet ta pranojmë. Por jeta e njeriut nuk ka të njëjtin vlerë në Greqi dhe Turqi. Turqia është vend i botës së tretë ku mijëra njerëz vriten pa u folur fare për ta". Kryeministri grek Al-



Anijet greke në detin Egje

exis Tsipras nuk e çoi për dekret presidencial zgjerimin me 12 milje të hapësirës de-

tare greke, por tha se do të kërkojë edhe mendimin e deputetëve dhe grupeve shken-

ZËDHËNISI I ERDOGANIT

"Kjo është një sjellje e rrezikshme. Hapësira që ata e njohin si 'zona 7' është pjesë e shelfit tonë kontinental. Përgjigja e merituar do t'u jepet nga forcat tona të armatosura, që nuk do të hezitojnë të përmbushin kërkesën e Republikës së Turqisë", - ka thënë zëdhënisi.

marrëdhënieve dypalëshe dhe stabilitetit rajonal", thekson MPJ turke. Në komunikatë nënvizohet, gjithashtu, se Turqia do të vazhdojë të përdorë në platformën e saj kontinentale të drejtat dhe kompetencat sovranë që burojnë nga e drejta ndërkombëtare. Kujtojmë se që prej kohësh këto dy shtete i kanë acaruar marrëdhëniet e tyre për shkak të konfliktit mbi përkatësinë e ishujve, që Turqia i njeh me emrin Kardak, ndërsa Greqia Imia, të pozicionuar mes ishullit grek Dodecanese dhe brigjeve të Turqisë jugperëndimore, një incident i rrezikshëm raportohet të ketë ndodhur në muajin shkurt të këtij viti. Në ishujt e shumëpërfolur, një anije patrullimi turke ka goditur anijen greke që ishte e ndaluar në det. Anija greke pa pësuar vetëm dëme materiale në pjesën e pasmes të saj, ndërkohë që incidenti nuk është raportuar në median turke. Ky është incidenti i parë serioz mes dy vendeve gjatë muajve të fundit pas fërkimeve të shumta në këtë zonë, një mosmarrëveshje që zgjat prej dekadash mes Turqisë dhe Greqisë, mbi ishujt e pabanuar në Egje. Konflikti ky që i vendosi të dy vendet në prag të një konflikti të armatosur në 1996 kur Ankaraja dhe Athina dërguan forcat detare në dy ishuj fqinj si shenjë e një konfrontimi të pritshtëm. Më pas, të dyja vendet i tërhoqën trupat pas presionit diplomatik të shteteve të bashkuara.

SHKURT

Gjendet kutia e zezë e aeroplanit që u rrëzua në det

Autoritetet në Indonezi kanë arritur të gjejnë kutinë e zezë të aeroplanit që u rrëzua në detin Java. Aeroplani Boeing 737 i kompanisë "Lion Air", me 189 pasagjerë në bord, u rrëzua ditën e hënën në det pak pasi u ngrit në fluturim nga Xhakarta, kryeqyteti indonezian. Kutia që mban të dhënat e fluturimit JT 610, pritet të ndihmojë ekspertët për të përcaktuar shkakun e rrëzimit të aeroplanit. Ndërkohë që nuk janë bërë të ditura shkaqet e rrëzimit, por mendohet se aeroplani ka pësuar një problem teknik gjatë fluturimit të tij të parafundit. Ndërsa piloti i kishte kërkuar kontrollin të trafikut ajror leje për t'u kthyer në aeroport, por më pas humbi kontaktet. Nga rrëzimi i avionit nuk është gjetur asnjë i mbijetuar.

Kumanovë/ Përplasia me armë, humb jetën 1 nga 5 të plagosurit

Dy familje shqiptare në Kumanovë të Maqedonisë janë përfshirë në një konflikt me armë zjarri gjatë mbrëmjes së djeshme. Ngjarja ndodhi rreth orës 18:00. Për shkak të plagëve të marra, njëri nga 5 të plagosurit ka humbur jetën në spital. Viktima është identifikuar si Vebi Maksuti. Mediat vendode raportojnë se anëtarë të familjes Latifi dhe Maksuti fillimisht janë përplasur verbalisht, e më pas shërri ka degeneruar në përdorimin e armës. Grupi hetimor ka nisur prej mbrëmjes së djeshme hetimet për rastin, por ende nuk ka arritur në dokumentimin e plotë të kësaj ngjarje, e cila la pas 1 të vdekur dhe 4 të plagosur.

Tajlanda, shteti i radhës që do legalizojë marrënjën

Tajlanda shpreson të bëhet vendi i parë në Azi që do legalizojë marrënjën mjekësore dhe të futet në tregun e kanabisit, raporton Agence France-Presse. Sipas një zryrtari tajlandez, po shqyrtohet një projekt-ligj për lejimin e marrënjës për qëllime mjekësore, një ndryshim i konsiderueshëm në një vend me ligje të ashpër për trafikimin e drogës. "Theksohet se marrënjua do të jetë e ligjshme vetëm për ilaçe dhe jo për gëzim. Por legalizimi i drogës mund të jetë një ndihmë ekonomike dhe mundësi për popullin tajlandez," tha Jet Sirathraanon, kryetari i komitetit të shëndetësisë publike të Asamblesë Kombëtare Legjislativë të Tajlandës. Tregu global i marrënjës mund të arrijë në 55.8 miliardë dollarë deri në vitin 2025, sipas një analize të publikuar vitin e kaluar nga Grand View Research. Dhe Jet pret që Tajlanda të kapë një pjesë të mirë të tregut multi-miliardë dollarësh me atë që ai e konsideroi si "marrënjua me mirë në botë".

Gjykata e Shkupit 'ngrin' selinë e partisë opozitare

Rasti "Tallir", bllokohen 69 prona të VMRO-DPMNE në Maqedoni për pastrim parash

Gjykata e Shkupit ka ngrirë 69 prona të VMRO-DPMNE në Maqedoni, përfshirë edhe selinë qendrore të partisë më të madhe opozitare. Pronat janë ngrirë me kërkesë të Prokurorisë Speciale pasi janë të përfshira në një hetim. "Me këtë masë ndalohet shitja e pronave konkrete, dhe ndalohet edhe dhënia me qira", theksohet në njoftimin e



Prokurorisë Speciale. Këto veprime u ndërmorën në kuadër të rastit "Tallir".

Prokuroria dyshon se disa nga këto prona mund të shiten pas mbarimit të procedurës. Rasti Tallir ka të bëjë me financimin e paligjshëm të VMRO-DPMNE-së dhe pastrimin e parave nga kjo parti. Të dyshuar në këtë rast janë shumë ish-funkionarë të lartë të partisë opozitare, përfshirë ish-kryeministrin Nikolla Gruevski.

core përpara se ta hedhë për votim në parlament. Ndërkaq dhe para disa ditëve Turqia ka paralajmëruar Greqinë dhe e ka porositur të evitohet veprimet që mund të shkaktojnë një përshkallëzim në rajon (Mesdhe), thuhet në një komunikatë me shkrim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë, ku rikujtohet se duke nisur nga mëngjesi i 18 tetorit kanë nisur aktivitetet e reja kërkimore sizmike në platformën kontinentale turke në Mesdhe nga anija "Barbaros Hayreddin Pa'za". Deklarata për media e bërë dje në lidhje me këtë çështje nga Ministria e Jashtme e Greqisë është plotësisht e pabazuar nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare. Këmbëngulja e Greqisë në pretendimet jo-realiste s'do të ketë asnjë rezultat tjetër veçse dëmtimit të

TAKIMI

Bora, Gjina, Mimoza e Shqiponja, zonjat kineze që merren me kulturën shqiptare

Doktorata e prof. Ke Jing (e Gjines), tashmë e botuar, ka për objekt rolin përrues, ndërtesat e rindërtues të veprës së I. Kadaresë në identitetin shqiptar, përmes opozicionit vetja-tjetri. Doktorata e prof. Chen Fenghua (e Mimozës) u mbrojt me një tezë për ndikimin e filmit shqiptar në kinemanë kineze. Një studiuese e re, me emrin shqiptar Bora, sapo mbrojt doktoratën me një studim krahasues midis letërsisë së Kadaresë dhe asaj të Ivo Andri?-it.

Katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit, apo Bie-Wai, siç njihet në Kinë, Pekin, është një njësi mësimdhënëse universitare dhe në të njëjtën kohë edhe një qendër formimi e kërkimi shkencor. Të tri këto funksione i bashkon albanologjia. Shkolla e doktoratës tradicionale ka pasur një paradigme të mirëfilltë albanologjike, ose kushtuar lidhjeve sino-shqiptare. Problematika e doktoratës së pedagogëve e studiuesve të kësaj katedre ka të bëjë me raportet midis shtetit dhe besimit në Shqipëri në shekullin XX, me letërsinë sociale në Shqipëri e në Kinë në vitet 1930 (duke pasur si referencë themelore krahasuese Migjenin dhe poetin kinez Lu Sin); me imazhin e Kinës në Shqipëri etj. Pedagogët e katedrës së shqipes dhe bashkëpunëtorët e saj janë njëherësh dhe përkthyesit e letërsisë shqipe në gjuhën kineze. Mimoza ka përkthyer "Aksidentin" e Kadaresë; një kolege e re me emrin shqiptar Shqiponja po përkthen një koleksion dokumentesh për lidhjet kino-shqiptare në vitet 1960-1970; prof. Gjina ia ka vënë syrin "Arkës së djallit" të Dritëro Agollit. Nuk janë jashtë vëmendjes edhe vepra e autorit të kohëve të reja, si Fatos Kongoli, Bashkim Shehu, Nasi Lera dhe të tjerët. Përkthyesi Zheng En Bo, një senior i gjuhës shqipe në Pekin, ka botuar vëllimin e parë dhe së shpejti boton vëllimin e dytë të një antologjie të poezisë shqipe me rreth 70 autorë, që nga De Rada deri te Mimoza Ahmeti. Kjo ndërthurje e suksesshme e tri funksioneve: universitare, kërkimore-shkencore dhe letrare, dëshmoret shumë rrallë në njësi e katedra të tjera. "Enciklopedia e shkurtër e historisë dhe e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë" është një prej dëshmive të karakterit shumanësh të punës së katedrës së shqipes në BFSU. Ajo është përgatitur nën drejtimin shkencor të prof. Ke Jing, me bashkëpunimin e pedagoges së re Ma Sai (Bora), e cila, meqë ra fjala, në konferencën shkencore të para tri ditëve në Beograd të titulluar Mapping Balkan Routes: linguistic, literary and cultural landscape, paraqiti një kumtesë shumë dinjitoze. Çfarë është kjo enciklopedi? Unë nuk e njoh gjuhën kineze, por mund t'u bëj të njohur të pranishmëve një panoramë të përmbajtjes së saj duke i referuar tek-



Studiueset kineze në Tiranë

stët shqip dhe anglisht mbi të cilin është mbështetur botimi dhe sidomos një dialogu shumë intensiv që kemi pasur me dy autorët e botimit gjatë kohës së përgatitjes së tij. Kjo është një enciklopedi e formatit evropian, jo vetëm për faktin se botimi i parë i saj, që ka shërbyer si bazë edhe për botimin në gjuhën kineze, është mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe UNDP, por mbi të gjitha për mënyrën si janë përzgjedhur kryeveprat e trashëgimisë materiale e jomateriale shqiptare për t'i përruar në mjedisin kinez. Një kapitull u është kushtuar pasurive arkeologjike shqiptare, shtresave të kryehershme të saj, me një vëmendje të posaçme për sitin arkeologjik të Butrintit, pasuri e UNESCO-s. Rregullimi urban i jetës qytetare në Shqipëri, arkitektura popullore dhe ajo makrometrike zënë një kapitull tjetër, dhe në këtë rast Gjirokastra e Beratit zënë kryet e vendit, duke qenë, gjithashtu, dy qytete që janë nën mbrojtjen intelektuale të UNESCO-s. Sa i takon historisë së popullit shqiptar, etnogenezës, lashtësisë, burimit, vazhdimësisë, këto çështje janë renditur në një kapitull tjetër, në të cilin shumë rëndësi ka sidomos periodizimi i historisë së periudhës shtetërore, duke i referuar alternativëve të herëpashërme të sistemit shoqëror nga principata e trashëgueshme të kështilli i shtetit apo regjencia, forma të kurorës popultrake, nga republika në monarki etj. Origjina e shqipes dhe historia e zhvillimit të saj si gjuhë e shkruar, pa lidhje gjenetike me degë e nëndegë gjuhësh të tjera të së njëjtës familje; lindja, zhvillimi, periudhat dhe personalitetet më të rëndësishëm të letërsisë shqipe prej Gjon Buzukut deri te brezi i

shkrimtarëve dhe poetëve post-Kadare; paraqiten me gjuhë të thjeshtë, por duke i përmbajtur

Enciklopedi e shkurtër e historisë dhe trashëgimisë kulturore të Shqipërisë në Pekin



PERKTHIMET

Pedagogët e katedrës së shqipes dhe bashkëpunëtorët e saj janë njëherësh dhe përkthyesit e letërsisë shqipe në gjuhën kineze. Mimoza ka përkthyer "Aksidentin" e Kadaresë; një kolege e re me emrin shqiptar Shqiponja po përkthen një koleksion dokumentesh për lidhjet kino-shqiptare në vitet 1960-1970; prof. Gjina ia ka vënë syrin "Arkës së djallit" të Dritëro Agollit.

tezave të vërtetueshme shkencore. Në mënyrë më të përqendruar në këtë enciklopedi janë paraqitur disa trashëgimi që zakonisht një-

KRAHASIMI

Problematika e doktoratës së pedagogëve e studiuesve të kësaj katedre ka të bëjë me raportet midis shtetit dhe besimit në Shqipëri në shekullin XX; me letërsinë sociale në Shqipëri e në Kinë në vitet 1930 (duke pasur si referencë themelore krahasuese Migjenin dhe poetin kinez Lu Sin).

huajve më së pari, ku, ndonëse sundon romantizmi e ekzotika, bota shqiptare shpërfaqet me denjësi. Nuk mungojnë vrojtimet demografike, demokulturore e demonetike, që pasurojnë pamjen e përgjithshme të vendit, ashtu sikurse dhe historia e institucioneve më të rëndësishme kulturore, arsimore dhe shkencore, duke përfshirë Universitetin e Tiranës, Akademinë e Shkencave, Radio-televizionin Shqiptar etj. Siç përmenda, gjatë përgatitjes së këtij botimi kemi komunikuar rregullisht me kolegët nga Pekini, dhe me këtë rast kemi vërejtur se teksti anglisht përmban edhe ndonjë pasaktësi apo gabim, që në botimin kinezisht është rregulluar. Kështu, për shembull, për një keqkuptim apo më saktë për shkak të një leximi të përciptë, titulli i portretit të njohur të Kolë Idromenos 'Motra Tone' në anglisht ishte përkthyer Our Sister, kur në të vërtetë duhej përkthyer Sister Antone; sepse Tone është shkurtim i Antone, Ndonia që përdoret tek arbëreshët. Po ashtu, emri i Shën Gjon Gojartit, Shën Gjon Chrysostome-it, ishte përkthyer Saint John Goldmouth; që për lexuesin e anglishtes nuk ka ndonjë kuptim. Me një fjalë, nëse miku ynë Genc Myftiu do të përgatisë një botim të ri në anglisht të tekstit të mëparshëm, nga përkthimi i krahasuar në kinezisht, me dy tekste përpara, shqip dhe anglisht, përvoja e prof. Gjines dhe e dr. Borës do të ishte shumë e vlefshme për saktësim. Por këtu është rasti para së gjithash për ta falënderuar Gencin për mirësinë e tij, për gatishmërinë për të ofruar pa kushte gjithçka që kishte koleksionuar prej kontributeve të studiuesve për çështjet e mësipërme, ku mund të përmenden Muzafer Korkuti, Seit Mansaku, Jorgo Bulo, Ferid Hudhri dhe disa të tjerë. Tani nuk më mbetet tjetër veçse të përgëzoj prof. Ke Jing dhe bashkëpunëtorët e saj të zellshme Ma Sai për botimin dinjitoz, që me siguri do të nxisë vëmendje dhe dashamirësi ndaj traditave shqiptare.

STUDIMI

Fatmira Nikolli

MUSINE KOKALARI

Kur gratë shfaqnin guxim


Fiona Todhri dhe Eris Dha mo shënojnë që në krye të herës se ngjarjet fillojnë dhe zhvillohen në një vend që sapo ka dalë i shkatërruar pas luftës së '44-ës dhe rrymës së re, si edhe formës së pushtetit që kërkon të uzurpojë vendin dhe gjithë shoqërinë e atyre viteve. Sa shumë ngjarje, përjetime, emocione gjenden te figurat historike shqiptare që hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë. "Punimi është një përjekje për të zbardhur disa fakte, dëshmi dhe, mbi të gjitha, përjetime të ndryshme, por që kanë të përbashkëta midis tyre. Nëse do t'i referohemi proces-verbaleve gjyqësore që janë mbajtur për këto gra të dënuara politike, letërkëmbimeve, mbrojtjes, deponimeve, si dhe akuzave të bëra gjatë gjykimit ose/dhe mungesës së gjykimit, dorëshkrimeve, punimeve dhe mbrojtjes së disertacioneve, në rreshtat e tyre gjejmë forcë mendimi kritik, ideale, personalitete të hekurta, të forta, pavarësisht vuajtjeve apo përdhosjes së dinjitetit që i bëhej nga pushteti i asaj periudhe. Gjatë shfletimit të dosjeve, të bien në sy kryesisht disa karakteristika, përshkrimi i të cilave qoftë me fjalë me kuptim të drejtpërdrejt apo të figurshëm (me anë të epitetëve, metaforave etj.), nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së tyre, duke u ndalur sidomos në vlerësimin e vetdijes intelektuale, integritetit, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte.

Nëpër rreshtat që janë shfletuar e lexuar, vërehet ndjenja e shpresës, optimizmi, spikat vetëbesimi, portretizimi i grave që nuk u dorëzuan kurrë, edhe kur u torturuan, edhe kur u dëbuan në skutat më të errëta të vendit të tyre", shënojnë Todhri e Dhamo në studimin e tyre që u bë publik gjatë konferencës "Të mohuar nga regjimi", mbajtur në Tiranë nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Sigurimit të Shtetit më 30-31 tetor. Dy studiueset vënë në dukje se puna e tyre, kaloi

nëpërmjet një procesi sistematik të ekzaminimit të dokumentacionit, fakteve, procesverbaleve, fotonave të shkruarës për të kuptuar qëndrimet dhe sjelljen e grave, në referencë të hapave të ndryshëm të persekutimit historik. Për këtë studim janë përdorur të dhëna parësore të dokumenteve origjinale të AIDSSH; janë rreth 821 faqe format A4 me të dhëna nga disa institucione aktive të ish-sistemit komunist si ish-Gjykata e Lartë Ushtarake, ish-Sigurimi i Shtetit, Hetuesia.

MBI MUSINENË

"...Përgjegjëse e Gazetës 'Zëri i Lirisë' kam qenë unë, edhe kam shkruar. Nuk di nëse gazeta ishte legale apo ilegale, por unë e drejtoja dhe shpërndahesh prej disa të rinjve..." Studimi vë në fokus një figurë përfaqësuese si Musine Kokalari, jeta dhe aktiviteti i së cilës, ndahet mes përvojës akademike e pasionit të saj për letërsinë, që përbën fushën e studimeve të saj universitare. Pastoni për të shkruar dhe afërsia e saj me librat, e bëjnë një figurë të formuar intelektual. Musineja kishte dhe një librari të cilën e administronte dhe kalonte kohën më të madhe, ku edhe ushtronte veprimtarinë dhe angazhimet e saj politike, shënojnë Dhamo e Todhri. Sipas tyre, referuar raportimeve dhe proces-verbaleve të mbajtura gjatë gjykimit të saj, pohohen vazhdimisht takimet e saj me grupet e interesit, si aktiviste dhe mjaft e përfshirë në jetën politike të vendit si gjatë luftës, dhe pas saj. Përveç pasionit të saj për të shkruar, ku mund të përmenden



edhe librat, si: "Seç më thotë nëna plakë", "Rreth vatrës", ajo drejtoonte dhe shkruante për gazetën "Zëri i Lirisë", të cilën e konsideronte si një mekanizëm mjaft të rëndësishëm për të shpërndarë në mbarë vendin dhe jashtë tij bindjet dhe frymën politike jo vetëm të saj, por edhe të disa grupeve të tjera në vend.

Ngjarjet zhvillohen gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe pas saj. (1939-1946). Aktiviteti i saj politik duket shumë i ngjeshur dhe me shumë kontakte pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Raportohet një bashkëpunim edhe me grupime të tjera që pothuajse kishin të njëjtat ambicie për zhvillimin e vendit, dhe

përfaqësimin e tyre në nivele të larta vendimmarrëse, si: Balli Kombëtar, Monarkistët, Grupi i Rezistencës, ku ky i fundit u pagëzua nga vetë M. Kokalari.

"Në lëvizjen e saj fokus të veçantë kishin të rinjtë dhe gratë, të cilët i angazhonte duke marrë pjesë në mbledhje, në zgjerimin e partisë dhe rritjen e përfaqësimit në popull. Musineja krijoi Partinë Socialdemokrate me qëllimin e rritjes së frymës opozitare në vend dhe përfaqësimin e saj në parlament. Programi i partisë përbante disa pika: 1) Sigurimin e një Shqipërie Indipendente në popull. Musineja etnik (të pavarur); 2) Reforma Sociale duke u ruajtur gjithnjë traditat e mira dhe zakonet kombëtare; 3) Reforma me karakter ekonomik; 4) Mbrojtja e një Xhandarmerie për ruajtjen e rendit publik; 5) Shpallja e neutralitetit të Shqipërisë të garantuar nga Fuqitë e Mëdha Ndërkombëtare; 6) Administrimin e Shqipërisë me një sistem demokratik përëndimor; 7) Shpallja e lirisë së besimit, të fjalës, të shtypit e të tjera.; 8) Sigurohet barazia e të drejtave të qytetarëve", shënojnë dy studiueset Todhri e Dhamo.

Shtojnë se atdheadashuria për vendin dhe vëmendja e saj e vazhdueshme mbi çështjet etnike, liria e fjalës së shtypit, drejtësia sociale, ishin fjalët kyçe të gjithë aktivitetit të saj politik. Si demokracia e vendit, por dhe Kosova, perceptohen si lufta e saj me aleatët brenda dhe jashtë vendit.

Transparenca e mendimit dhe veprimet janë elemente që vihen re në proces-verbale të mbajtura gjatë ditëve të gjykimit të saj.

"E pandehura Musine Kokalari: _ Grupi jonë e firmosi notën, nënshkruam unë,fq. Grupin e Rezistencës e kam pagëzuar unë, kur mora vesh se kish të lidhje me ato të maleve", thoshte ajo.

"Duke parë zhvillimin e procesit, e shoh të arsyeshme të them vetë se i gjithë aktiviteti i atij grupi të vogël Social Demokrat nuk është gjë tjetër veçse një notë e drejtuar aleatëve të perëndimit për shtymjen e votave kur qeveria u njoh me të drejtë opozite. Një hap i tillë nuk do të thotë përmbyseje e pushtetit të sotëm me violence se ne, 37 të pandehurit, në bankën e të akuzuarve nuk jemi pjesëtarët e një organizate, por anëtarët e katër korentëve të ndryshme, tri jashtë fronit dhe i katërti i dalë nga gjiri i tij dhe i shkëputur që andej. Katër korentë me koncepte politike -shoqërore të ndryshme dhe vetvetiu me veprimtari të përshtatur që pas frymës që përmban, duke qenë secili përgjegjës për veten ...". -shprehejMusineja.

L'ARCHIVIO MARUBI | **MARUBI ARCHIVE**



Il Rituale Fotografico
The Photographic Ritual

A cura di/Curated by Zef Paci

La Triennale di Milano

16.11.2018 / 11:30 AM
16.11.-9.12.2018

EKSPOZITË E MUZEUT MARUBI NË "LA TRIENNALE DI MILANO"

E kuruar nga Zef Paci çëlet më 16 nëntor ekspozita "L'archivio Marubi. Il rituale fotografico", nw "La Triennale di Milano". Mes të përditshmes dhe ritualit, imazhet e ekspozitës "L'archivio Marubi. Il rituale fotografico" (Arkivi Marubi. Rituali fotografik) e kuruar nga Zef Paci, ruajnë kujtesën e mbi një shekulli jetë. Bëhet fjalë për trashëgiminë fotografike të Muzeut Marubi në Shkodër, i pari muze fotografie, i cili në datat 16 nëntor deri më 9 dhjetor 2018, paraqet në Triennale di Milano, ekspozitën e tij të parë në bashkëpunim me La Triennale dhe Museo di Fotografia Contemporanea. Për këtë ekspozitë janë përzgjedhur rreth 170 fotografi prej autorëve më të njohur të koleksionit. Imazhet që do të shfaqen janë shkëputur prej vazhdës së formuar nga fotografët, të yjezuar prej sh-

krepjeve të tyre e të shkëputura prej vetë vazhdës së jetës. Bashkësia e këtyre gjurmëve dhe fragmenteve të jetës të shkëputura nga fluksi i përditshmërisë, ndërton një narracion përmes fotografisë, një rrugëtim përmes vendeve, fytyrave, marrëdhënieve njerëzore që hetojnë ritet e kalimit që në shekuj u fiksuan nga rituali fotografik. Fotografia si ritual na ka lejuar të gjejmë komunitetin e historitë e tij të shumta me dëshirat për t'i dhënë publikut shijen e një realiteti shumëformësh e eklektik. Kjo ekspozitë organizohet nga Muzeu Marubi në kuadër të kalendarit të "Vitet Mbarëkombëtar Gjegj Kastrioti -Skënderbeu" në ambientet e La Triennale di Milano, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Museo di Fotografia Contemporanea dhe Ambasciata d'Albania in Italia / Ambasada e Shqipërisë në Itali.

Opinion *i* Ditës

Në Kryeministri ka pllakosur paniku

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... të preket nga to. Ne të gjithë mund të qeshim me ato që kumton "qytetari dixhital" i Berishës - dhe ai vetë, na ka dhënë mëse një rast për këtë, - ne si shumëkush mund të jemi skajshmërisht mosbesues ndaj Bashës, pasi ai më shumë se një herë e ka përqeshur të vërtetën, por në asnjë mënyrë, ne nuk mund të mos mbajmë shënim mënyrën se si po sillet Edi Rama në këtë situatë të re.

Dhe këtu nuk e kam fjalën për momentet e aktrimit prej kllouni, në të cilat ai shkëlqen si askush tjetër, as për fabulat që tregojnë se gjithçka është një farsë e përgatitur në Kinostudion e SHQUP-it, as për promovimin televiziv të mod-eleve idioeske të "Xhuxhit", që tentojnë t'i mbysin faktet duke i qesharakizuar.

Aspak. Mënyra për të kuptuar është të përpiqesh të lexosh aktet institucionale që po ndërmerri Rilindja. Dhe ato janë lehtësisht të lexueshme.

Sot, agjencia investigative BIRN zbuloi një dokument skandaloz të miratuar nga Kuvendi, i cili mëton t'u japë një korracë më të fortë imuniteti deputetëve. Sipas tekstit të bërë publik edhe nga "Lapsi.al", në këtë dokument aludohet se rilindasit duhen mbrojtur nga arrestimet, pasi duke kërkuar ato, prokuroria mund të dojë të bëjë një komplot për të krijuar destabilitet.

Kjo, logjikë halucinante që të kujton, si lajthitjet e çartura të Berishës su 21 janarit, po ashtu edhe ato të Edi Ramës pas denoncimeve të nënkomisar Nuhut,



është e qartë se kërkon të mbrojtë pjesëtarët e organizatës kriminale të Rilindjes nga denoncimet e ardhshme.

Edhe më e fortë bëhet kjo hipotezë kur kujtojmë se qeveria ka ndërmarrë një nismë për forcimin e ligjit kundër shpifjes, me shpresën se do të pengojë opozitën dhe mediat të publikojnë materialet që kanë nëpër dosje.

Edhe më e besueshme bëhet ajo, po t'i shtosh faktin se tentativa e

parë u bë duke vënë në krye të institucionit të akuzës, një kryeprokurore kamikaze, për të cilën fillimisht u tha se do të qëndronte dy-tre muaj, se nuk do të bënte zëvendësime të varësve dhe nuk do të ndërhynte në çështje konkrete.

Por, me sa duket tani zullumi është aq i madh, sa atë nuk mund ta mbulojë një militant e mangët si Arta Marku.

Prandaj, Rama ka kaluar në

shtimin e masave të tjera që tregojnë se ai po vepron duke improvizuar në panik.

Është pikërisht kjo zemërdridhje dhe frikë, që pjell absurditete të tilla, si dokumenti i zbuluar sot, i cili tenton të forcojë imunitetin e deputetëve ndaj arrestimeve.

Dhe janë këto masa që na tregojnë qartë peshën e 'bombave' që parathotë opozita, sado mosbesues që ne të jemi ndaj saj.

HOROSKOPI

DASHI
Karriera do t'ju shkojë mirë. Do t'ju tregoni njerëzve të rëndësishëm aftësinë tuaj për të përballuar projekte të mëdha, dhe jeni gati për një pozicion më të lartë. Nëse punoni fort, keni gjasa për një ngritje në pozicion.

DEMI
Do të jetë një ditë e jashtëzakonshme për vlerësimin profesional. Do të shfaqni aftësitë tuaja më të mira. Nëse jeni të vetëpunësuar, mund të merrni një promovim. Gjithçka do të jetë fantastike.

BINJAKET
Nëse ndjeni se nuk keni romancë në jetën tuaj, dita do të jetë hyjnore. Nëse jeni beqar/beqare dhe jeni në kërkim të njeriut të duhur, sot do t'ju jepet mundësia për të takuar një njeri interesant.

GAFORJA
Në qoftë se keni shqetësime, nuk do të gjeni rehat derisa çdo gjë të rregullohet. Sot nuk ka mundësi që gjërat të shkojnë keq pasi yjet do ju favorizojnë veçanërisht në sektorin e punës.

LUANI
Në qoftë se dëshironi të ndërtoni një marrëdhënie të re shoqërore, shanset janë që gjërat të mos shkojnë sipas planit. Megjithatë në punë do të vlerësoheni në maksimum falë aftësive tuaja.

VIrgJERESHA
Mund të ndërmerrni një udhëtim të largët që do ju japë ide të reja rreth karrierës tuaj. Ndjeni nevojën për të pushuar në një vend të qetë. Zgjidhni një vend pranë një liqeni ose pranë detit dhe do të kënaqeni pafund.

PESHORJA
Keni kaluar shumë sfida ditë e fundit, megjithatë, jeta ka uljet dhe ngritjet e saj. Universi mund të korrigjojë gabimet e së shkuarës dhe frustrimet që ju kanë penguar deri tani, do të zhduken.

AKREPI
Është momenti që të reflektoni për jetën tuaj të tanishme dhe çfarë do të doni të arrihi në të ardhmen. Mendoni për gjërat specifike që mund t'ju bëjnë të lumtur. Mos e humbni këtë mundësi, sepse e nesërmeja do të jetë thelbësor për arrijtjen e tyre.

SHIGJETARI
Nëse keni menduar të bashkoheni në një grup vullnetarësh, është koha ta bëni pasi do të keni përfundim, të cilat nuk i prisni. Do të shijoni kohën me miqtë, të cilët ndajnë të njëjtat interesa me ju.

BRICJAPI
Duhet të kërkonti dhe shfrytëzoni mundësitë e reja që ju ofron aspekti planetar. Në këtë ditë mund të bëni një prezantim ose një intervistë për një hap të rëndësishëm në karrierë. Mund të merrni lajme të mira si blerja e një shtëpie.

UJORI
Nëse do t'ju duhet të udhëtoni për biznes, merrni me vete partnerin tuaj sepse kjo ditë do t'ju lejojë të kombinoni lehtësisht punën me kënaqësinë. Bëhuni gati për duartrokitje, publicitet dhe një ofertë të mundshme në punë.

PESHQIT
Një rritje page parashikohet për të lindurit në këtë shenjë. Duhet të veproni me zgjuarsi, sepse njerëz xhelozë mund të përpiqen t'ju pengojë. Në dashuri kërkonti më shumë impuls, por ai mundon.

BLUE TOOTH
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

GAZETA SHQIPTARE

Intervista
e Ditës

Nr. 1 i Komitetit Amerikano-Hebraik: Vizita e Netanjahut, dritare mundësisë

"Diplomaticus"/ Leibovich: Izraeli mund t'i ofrojë njohuri Shqipërisë në teknologji

(vijon nga faqja 1)

... në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Kështu shprehet kryetarja e Komitetit Amerikano-Hebraik (American Jewish Committee), znj. Avital Leibovich në një intervistë për emisionin "Diplomaticus" në televizionin "News 24", program që drejtohet nga gazetari Erion Kaçorri. Leibovich thekson se populli shqiptar duhet të ndihet krenar për këtë vizitë të planifikuar të kryeministrit Netanyahu në Tiranë.

"Janë kaq shumë vende të cilat dëshirojnë marrëdhënie të ngushta me Izraelin dhe fakti që kryeministri Netanyahu zgjodhi Shqipërinë për të zhvilluar një vizitë historike, mendoj se i thotë të gjitha. Kjo vizitë që do të zhvillohet së shpejti është e rëndësishme, sepse ajo hap një sërë dritarësh për lloje të ndryshme bashkëpunimi. Izraeli është i njohur në të gjithë botën për teknologjinë dhe inovacionin dhe këtë eksperiencë mund ta ndajë me Shqipërinë, në mënyrë që të rinjtë e këtij vendi të mos largohen nga atdheu i tyre", shprehet znj. Avital Leibovich për "News 24".

Kryetarja e Komitetit Amerikano-Hebraik ndalet të mundësitë e mëdha që ka Shqipëria për investitorët izraelitë. "Bujësia është një



fushë me interes. Mund të flasim për burimet ujore, pasi Shqipëria është vend i pasur në këtë fushë. Por gjithashtu do të dëshiroja të fokusoheshim te turizmi, sepse për herë të parë në historinë e marrëdhënieve tona ka pasur fluturime direkte nga Izraeli në Shqipëri. Është vetëm dy orë larg dhe shumë Izraelitë zgjedhën që gjatë

sezonit të verës t'i kalojnë pushimet në Shqipëri. Kam lexuar komentet e tyre. Kam parë fotografitë e tyre nga Shqipëria dhe të gjitha përshlypjet e tyre ishin vetëm pozitive. Mbresa e parë e turistëve izraelitë është se ndihen të mirëpritur në Shqipëri. Mbresa e dytë ka të bëjë me bukuritë e natyrës së Shqipërisë. Peizazhi,

malet, liqenet dhe deti. Në vlerësimin tim, mendoj se numri i turistëve izraelitë do të dyfishohet në Shqipëri", thekson personaliteti i njohur izraelit.

E pyetur nëse Komiteti Amerikano-Hebre e ka nxitur qeverinë izraelite për të njohur pavarësinë e Kosovës, Leibovich deklaroi se kjo është një çështje komplekse. "Ka të bëjë

me çështje të brendshme politike brenda vendit, por edhe në çështje të jashtme, për shkak të marrëdhënieve të Izraelit me vendet e tjera europiane. Shikoni, Kosova ka tani një mundësi, një dritare mundësisë për të hapur një zyrë për interes ekonomik në Izrael. Tani topi është në fushën e Kosovës, nëse zgjedhin të ecin përpara me këtë plan dhe personalisht më duhet të them se shpresoj që të ecin përpara. Mendoj se Kosova do të përfitonte nga kjo marrëdhënie". E pyetur në lidhje me çështjen e Jerusalemit, faktit që shkaktonte kaq shumë konflikt dhe çfarë ndjen kur Shqipëria voton në OKB pro palestinezëve, Leibovich deklaroi se për izraelitët, Jerusalemi është kryeqyteti i tyre sepse atje ndodhen të gjitha institucionet, ndërsa për votimin e Shqipërisë nuk ndihet mirë. "Nuk jam e lumtur për vendimin e Shqipërisë. E kuptoj dëshirën e Shqipërisë për t'u bërë anëtare e Bashkimit Europian dhe e kuptoj që kërkon të jenë në një linjë me politikën e BE-së, por e thënë kjo, edhe në Bashkimin Europian nuk ka unitet mbi politikën të ndryshme. Pra, mund të shikojmë opinionet e ndryshme. Shpresoj se do të ketë mundësi të tjera për të votuar ndryshe", deklaroi kryetarja e Komitetit Amerikano-Hebre znj. Avital Leibovich për televizionin "News 24".

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

GODITJA E RADHËS



Në dy sezonet e fundit, FSHF-ja ka paraqitur kandidaturën e saj zyrtare për të përfutur të drejtën e organizimit të Superkupës së Europës në Tiranë, por në asnjërin rast, UEFA nuk ia ka dhënë këtë të drejtë. Megjithatë, Federata Shqiptare e Futbollit ka këmbëngulur se me punë do të vijë dita që organizimi të

Superkupa e Europës, UEFA refuzon kandidaturën e Shqipërisë

bëhet në Tiranë, por mesa duket, UEFA është "lodhur" nga kjo këmbëngulje. Pak muaj më parë, ishte stadiumi i Portos, ai që u zgjodh për organizimin e Superkupës 2020, ndërkohë që FSHF shprehej se Shqipëria do të jetë sërish kandidat

për të provuar organizimin e kësaj finaleje. Por, ditën e djeshme, UEFA ka publikuar listën me vendet kandidatë për të organizuar në vitet e ardhshme finalen e Superkupës së Europës, Ligës së Kampionëve, Ligës së Europës dhe finalen e Ligës së

Kampionëve për femra. Në listën me vendet kandidatë, bie në sy mungesa e Shqipërisë dhe me shumë gjasa, UEFA ka refuzuar aplikimin e FSHF-së, duke qenë se në të dyja rastet e para nuk ka arritur të fitojë të drejtën për organizimin e kësaj finaleje.

"Një grek më pak, një bastard më pak", i kushton rëndë klubit të kuq, që pritet të apelojë vendimin



Jeton Selimi

Parulla antigreke, Partizani 2 ndeshje pa tifozë

Gjopa për Skënderbeun, Tiranën dhe Flamurtarin

I lir Daja, kundër Komisionit të Disiplinës. Trajnerit të Flamurtarit jo vetëm që nuk i ka pëlqyer ajo që Disiplinori i FSHF-së ka vendosur kundër mesfushorit Idriz Batha duke e pezulluar nëpërmjet pamjeve filmike, por pretendon se me të njëjtën monedhë duheshin hequr kartonët e verdhë të dhënë paarsye nga kryesori lezhjan El-dorian Hamiti. Megjithatë, trajneri kryeqytetas po e përgatit me qetësi takimin e rëndësishëm ndaj Kukësit.

PËRBALLJA ME VERILINDORËT

"Kukësi ka bërë më mirë se ne deri në këto momente, por ne kemi një bonus që në ndeshjen direkte të fazës së parë kemi marrë fitore. Luajmë në transfertë, në një fushë asnjëse, që do të thotë se të 3 rezultatet janë brenda. Duhet të bëjmë atë lojë që zhvilluam në pjesën e parë ndaj Teutës".

PRANIA E TIFOZËVE

"Ndeshja me tifozë është gjithmonë më e mirë, edhe nëse ata mbështesin vetëm ekipin kundërshtar. Do të mendoj anën pozitive, pra-



nia e tifozëve është motivuese, qofshin këta kundërshtarë".

VENDIMET E 'DISIPLINËS'

"Nuk e di çfarë mund të


SUPERLIGA		
TE PREMTEMEN		
Teuta - Tirana		14:00
Kukësi - Flamurtari		14:00
TE SHTUNEN		
Luftëtari - Laçi		14:00
Partizani - Kamza		17:00
Skënderbeu - Kastrioti		17:00
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Skënderbeu	10	23
Partizani	10	22
Kukësi	10	19
Laçi	10	16
Teuta	10	15
Flamurtari	10	15
Tirana	10	9
Luftëtari	10	9
Kamza	10	8
Kastrioti	10	4

ndodhë deri në momentin e ndeshjes. Ne kemi punuar gjatë gjithë javës me Bathën

në formacion, por tani nuk e kemi, meqë e dënoi 'Disiplina'. Do ta ndiejmë shumë mungesën e tij. Më mirë të presim orarin e ndeshjes për të parë se kë kemi në dispozicion. Nuk mund të merret vendim me pamjet filmike, sepse aty kanë qenë të gjithë arbitrat. Sepse i bie që edhe neve të na heqin 3 kartonë të verdhë që i kemi marrë pa të drejtë. Nëse përdorim pamjet, Veluti i hiqet kartoni, sepse nuk e ka prekur fare kundërshtarin. Nuk mund të merren vendime mbi vendimet e gjyqtarit".

OBJEKTIVI

"Edhe pse presidenti e thotë gjithmonë që objektivi është të kënaqim publikun vlonjat, synimi ynë është të luajmë në Europa League, pra të renditemi të paktën në vendin e tretë ose të katërt".



De Biaz mbrosh Strakoshën:

Është nga më të mirët në qarkullim

Ish-trajneri i Ko mbëtares, Xhani De Biaz, iu është përgjigjur kritikave të bërë ndaj Thomas Strakoshës, pas ndeshjes me Interin që përfundoi 0-3 në favor të zikaltërve. Sipas De Biaz-it, portieri shqiptar ka treguar se është një portier i madh. Për teknikun italianin, Strakosha është një ndër portierët e rinj më të mirë në Itali. Nuk mungojnë as ironitë ndaj Donarumës, që është konsideruar si një portier me të ardhme të madhe. "Unë mendoj se Thomas në sezonin e kaluar ka treguar se mund të bëjë gjëra të mëdha, se është një portier i madh por është ende i ri. E kam parë të përmirësuar në lojën me këmbë, por duhet të luajë vazhdimisht dhe të bëjë eksperiencë. Nuk më duket se ka portierë të tjerë të rinj që kanë bërë më mirë, mjafton të shohësh Donarumën", ishin fjalët e De Biazit për "Radio Sei".

Ndryshime të mëdha te gjirokastritët

Tavo lë Luftëtarin, Bekim Halili presidenti i ri



e tij janë zhvendosur në Gjirokastër dhe janë duke financuar për skuadrën e futbollit. Madje, ndryshe nga muajt e mëparshëm, kur te skuadra ka pasur edhe herë pas here probleme me

financat, kohët e fundit çdo gjë ka shkuar më së miri, ndërsa në kampin bluzi janë të përqendruar te sfida me Laçin ku synohet marrja e 3 pikëve, duke qenë se është një ndeshje shtëpie.

Spartaku i Moskës dhe Meksika joshin trajnerin


U shkarkua nga Reali, vijjnë ofertat e para për Lopeteguin



e mundshme për Lopeteguin, por niveli i kampionatit, e lë të zbehur si mundësi.

Një tjetër opsion që mund të jetë një alternativë konkrete për teknikun spanjoll është Kombëtarja e Meksikës. Në fakt, emri i Lopetegui është i dyti në listë për të marrë drejtimin e këtij ekipi, duke qenë se në plan të parë është Gerardo Martino, por nëse ky nuk vjen, atëherë me shumë gjasa do të emërohet Lopetegui. Kujtojmë se vetëm një ditë para se të niste Botërori, Lopetegui u shkarkua nga detyra si trajner i Spanjës, pasi u bë publik akordi me Real Madridin.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Salacrou dramaturg
- Blair e Ekozoristi.
- I bylyllit ai i Mjedës.
- Inicialet e Morricones
- Gjysmë vektor.
- Një port përballë Xhibutit.
- Në mes të Salt dhe City.
- Janë stacionet e beduinëve.
- Një pjesë e taktikës.
- Janë fitoföz partie.
- Janë firmat mashtruese.
- Përpunojnë nafte.
- Janë konservatorë.
- Është derri.
- Një monedhë maqedonase.
- Kufizojnë ambiente.
- Inicialet e Gould aktor.
- Fillojnë jetën.
- Janë dëshmorët.

- U shkrua nga Garcia Lorca.
- Janë baballarët.
- Tregon çmimin dhe modelin.
- Është ujëvara.
- Një mund të jetë mbi xhiro.

VERTIKAL

- Film i James Cameron.
- Jeronim de i Milosaos.
- Është doktori me bluzë të bardhë.
- Agjenci Informacioni Ndërkombëtar.
- Janë si jerm.
- Fillojnë lejen.
- Klikohet me mouse
- Një vegël.
- Luftohet me kinina.
- Janë cilësi.
- Janë reaksionet në epruveta
- Një sportist që kërcen me shkop.
- Janë tek në zhele
- Është kullë xhamie.
- Bëhet një për zakon.
- Gruaja e Fantozzi-t
- Gjysmë afërsi.
- Janë ndriçues.
- Nuk duhet shkelur një i tillë.
- U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
- Një fjalë për gjoja.
- Garbo e Kinemasë.
- Braktisi Didonën.
- Me të bëjnë një thikë.
- Mund të jetë gjaku.
- Janë dhoma.
- Ai dhe ajo.
- Ushtria republikane irlandeze.
- Agjenci Transporti Korçë.
- Me stpon në box.
- Inicialet e Moravia-s.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Ishte babai i parë.
- Indërmarrim progresistët.
- Thyhet një me kohën më të mirë.
- U braktis nga Helena.
- Seritë pa zë.
- Kryeqyteti i Kinës.
- Ramazotti këngëtar.
- Është sport me vozitje.
- Ndërmarre Industriale Rajonale.
- Janë sherre në shtyp.
- Inicialet e Clapton.
- Është shuma e brinjëve të drejtkëndëshit.
- Një letrar është tregimi.
- Fillojnë nazet.
- Matet pa kufij.
- Inicialet e Kokoschka piktor
- Kufiojnë mendimet.
- Bergman që qe aktore.
- Është shpërblimi në para.

VERTIKAL


- Wenger trainer.
- Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
- Një është edhe Bujar Lako
- Fillojnë mobilizimin.
- Institucione Rajonale Polake.
- Një rapper i famshëm.
- Kështu thirrje Ronaldo, bombieri brazilian
- Ndëzur në aparatutë.
- Një film i ribërë.
- Ekstreme në model.
- Dy asa.
- Është fytyra kamionit.
- Mund të bëhet me medalje trimërie.
- Mund të jenë të rastit.
- E ka simbolin TI.
- Është dëm, qeder.
- Inicialet e Tappert.
- Një pjesë e pejsazhit.
- Ndahet në barazim.
- Janë kandilë deti
- Hayëorth që qe aktore
- Është enë për të skuqur.
- Emri i Zola.
- Gjysma e globit.
- Janë në skaje.
- Kryqyteti i Letonisë.
- Eva... Isabel Allende-s
- Një stacion i famshëm orbital
- Inicialet e Lennon.
- Ditong në duet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2	1	4		3			5	9
		9		4	6	2		
3	7	9						1
5		4			8	9		
	3		8	7		6	5	
								2
	8							
				6		7		
4	9	6	7	5		2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	3	5	2	1	7	9	4	6
4	6	1	8	9	3	5	7	2
7	9	2	4	5	6	8	1	3
9	2	4	6	3	1	7	5	8
1	5	6	7	8	9	2	3	4
3	7	8	5	2	4	1	6	9
2	8	3	1	6	5	4	9	7
5	4	9	3	7	2	6	8	1
6	1	7	9	4	8	3	2	5

Argëtim filozofik

- Sfida më e vështirë është të jesh vetvetja në një botë, ku çdokush përpiqet të të bëjë të ndihesh ndryshe!
- Njeriu është i madh vetem kur meson se vërtet është shumë i vogël
- Njerëzit e mirë e të drejtë u ngajnë pemëve të mëdha, që lëshojnë hije për të tjerët, ndërsa vetë përvëlohen nga rrezet e diellit.
- Njeriu ka nevojë për arsim ashtu si bima për ujë
- Shkalla e parë e marrëzisë është të kujtohet se je i mençur

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

14	5	8	1	3	11	11	15	9	14	5	
2	8	2	9	2	6	15	9	2		17	11
6		6	5	8	2	6	8	2	8	2	14
	11	4	12	2	7	6	2	11	2		3
8	2	9	4	6	3	6	9	15	9	3	
9	8		3	2	12	4	7	3	2	14	
4	6	2	6		4	6	3	14	17		
8	5	13	19	4	9	3		3	15	6	
3	7		6	19	12	3	4	12		11	4
6	3	9	2	13	4	6	9	3	12	2	6
4	13	6	3	6	2	13	3	11	4		1
6	2	15		4	9		11	15	9	2	6

P	U	S	I	K	U	P	T	O	P
U	R	A	R	O	A	S	L	I	
S	I	P	E	L	E	R	I	N	A
H	P	A	N	O	R	A	M	A	T
T	R	I	P	A	N	O	Z	O	M
E	P	A	T	A	T	I	N	A	T
T	E	S	A	I	T	T	O	D	
I	A	R		P	R	A	N	I	M
R	I	C	H	T	E	R	S	I	L
S	T	I	L	E	T	E	U	K	E
R	U	Z		A	T	R	E		
R	I	C	H	A	R	D		T	A

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	P		M	P	K		A	G	I	M			
T	I	K	M	O	D	E	L	E	T	R	I		
K	A	P	I	T	E	N	E	T	R	I	Z		
P	I	R	A	T	E	R	I	A	S	O			
P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T	S		
E	R	C	G	E	R		O	R	A	R	I		
N	O	I	R	E	T	P	E	L	E	A			
M	T	N		M	A	L	O	R	E	T			
L	E	E	D	S		A	R	A	G	O	N		
A	T	T		A	I	E	G	E	S	T	E		
N	E	E	S	O	N	O	R	S	E	A	T		
G	U	T	U	S	O	E	D	I	T	E	I		
E	D		L	T	E	C	M	A	F	I	A		
C	K	O	P	E	R	R	D	E	R	R			
O	H	A	R	A	D	I	A	M	A	N	T		
S	T	A	D	I	M	E	T	I	R	A	N		
D	I	K	A	S	T	E	R	I	R	A			
M	E	N		N	E	I	S	S	A	N			
N	O	T	A	S	U		E	L	E	N	A		
O	R		T	R	I	M		A	B	O	N	E	
V	E	S		I	M	O		T	E	N	D	E	
A	A		A	M		E	N	E	T	R	E	N	E
K	A		R	A	K	T	E	R	E		T	T	R

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Forca e mendimit hy në punë më shumë se tehu i shpatës; prandaj ruaje atë dhe mbaje gati për ta përdorur në kohën e duhur
- Dyshimi është gur argjendari i së vërtetës, kush dyshon në marrëdhëniet e përditshme, s'gabon asnjëherë, kush dyshon në veprimet e veta, bëhet filozof
- Grada e qytetërisë dhe e moralit të një populli kuptohet nga këngët dhe lojërat e tij
- Gabimi i atij që punon me dëshirë dhe ende, është më i mirë se të qëlluari e atij që punon pa dashur

